

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE / ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.131 PRILL 2019





REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR

Syrja Xhelaj

REDAKTORË

Nuri Çuni

Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT

Jakup Gjoca - Greqi

Eugen Shehu - Zvicër

Përparim Kapllani - Kanada

Agim Cani - Gjermani

Enea Muhameti - Itali

KONSULENTË

Arian Leka

Zenel Anxhaku

Blerina Harizaj

Agim Zeka

Besnik Anxhaku

DESIGN

Studiograf "A&N"

**SHTYPET NË
SHTYPSHKRONJËN**


"Urtësia
Bektashiane"

Prill, 2019

Bektashizmi në Ballkan,



Tradita e simpoziumeve ndërkombëtarë rreth besimit bektashian, ka vijuar edhe këtë 20 mars, në mjediset e Selisë së Shenjtë Bektashiane. Historia më shumë se 800 vjeçare e këtij tarikati, baticat dhe zbatcat e tij në brigjet e lumit madhështor të Islamit, tendencat nacionaliste të shfaqura sidomos në viset ballkanike...



Prehje hyjnore

Tashmë katër prilli ka fituar vendin e vet, në ditët e shenjta të kalendarit bektashian. E kanë në sy të gjithë, klerikë e besimtarë nga teqja e ringritur e Gjakovës deri tek ajo e Lazaratit, nga Kuzum-Babai i Vlorës, deri në Harabati-baba të Tetovës. Madje edhe më larg akoma, nga teqja e Detroitit ...

PREHJE HYJNORE

Medita në hëti vjetëra e largëta nga këtu të myshkëlltë, do të bashkojë

Tashmë katër prilli ka fituar vendin e vet, në ditët e shenjta të kalendarit bektashian. E kanë në sy të gjithë, klerikë e besimtarë nga teqja e ringritur e Gjakovës deri tek ajo e Lazaratit, nga Kuzum-Babai i Vlorës, deri në Harabati-baba të Tetovës. Madje edhe më larg akoma, nga teqja e Detroitit ...

PREHJE HYJNORE

Medita në hëti vjetëra e largëta nga këtu të myshkëlltë, do të bashkojë

Tashmë katër prilli ka fituar vendin e vet, në ditët e shenjta të kalendarit bektashian. E kanë në sy të gjithë, klerikë e besimtarë nga teqja e ringritur e Gjakovës deri tek ajo e Lazaratit, nga Kuzum-Babai i Vlorës, deri në Harabati-baba të Tetovës. Madje edhe më larg akoma, nga teqja e Detroitit ...



Të pijmë nga burimet e dlira të Ehli-Bejtit

Martirizimi i Imam Hysenit, paqja qoftë mbi të, është shndërruar tanimë jo thjesht në një akt evokimi historik, por në një pelegrinazh që mbledh në gjirin e tij besimtarë myslimanë të etnive, racave dhe kombeve të ndryshëm.

TË PIJMË NGA BURIMET E DLIRA TË EHLI-BEJITIT

Kryegjyshi Bektashian, Haxhi H. Haxhi Dede Enver Beqiraj, hëti e shenjtë në Gurbetit dhe Bejtit

Martirizimi i Imam Hysenit, paqja qoftë mbi të, është shndërruar tanimë jo thjesht në një akt evokimi historik, por në një pelegrinazh që mbledh në gjirin e tij besimtarë myslimanë të etnive, racave dhe kombeve të ndryshëm.

TË PIJMË NGA BURIMET E DLIRA TË EHLI-BEJITIT

Kryegjyshi Bektashian, Haxhi H. Haxhi Dede Enver Beqiraj, hëti e shenjtë në Gurbetit dhe Bejtit

Martirizimi i Imam Hysenit, paqja qoftë mbi të, është shndërruar tanimë jo thjesht në një akt evokimi historik, por në një pelegrinazh që mbledh në gjirin e tij besimtarë myslimanë të etnive, racave dhe kombeve të ndryshëm.

Shembull devocioni

Shembull devocioni

Shembull devocioni

Shembull devocioni

Shembull devocioni

Shembull devocioni

Shembull devocioni

Njëzetëdy vjet më parë u shua njëri prej klerikëve të vyer bektashianë, jeta e të cilit kaloi përmes vështirësive të panumërta dhe kalvarit të egër komunist. Jeta e tij, ka qenë dhe mbetet një shembull lavdie për ata që ecin të papërkulur ...

DERVISH SUFA TË QOFSHIM FALË

DERVISH SUFA TË QOFSHIM FALË

DERVISH SUFA TË QOFSHIM FALË

DERVISH SUFA TË QOFSHIM FALË

DERVISH SUFA TË QOFSHIM FALË

DERVISH SUFA TË QOFSHIM FALË

Dervish Sufa të qofshim falë

Në vështrimin historik të përhapjes së bektashizmit në vendin tonë, i cili filloi në Krujë nga misionari Sarisalltik, bashkohës i Haxhi Bektash Velui në shekullin e XIII edhe sot kemi teqen në malin e Krujës dhe gjurmën në Krastë.

Simpozium Ndërkombëtar në Tiranë

Bektashizmi historia d



Tradita e simpoziumeve ndërkombëtarë rreth besimit bektashian, ka vijuar edhe këtë 20 mars, në mjediset e Selisë së Shenjtë Bektashiane. Historia më shumë se 800-vjeçare e këtij tarikati, baticat dhe zbaticat e tij në brigjet e lumit madhështor të Islamit, tendencat nacionaliste të shfaqura sidomos në viset ballkanike, por edhe sfidat e kapërcyera dhe të tjerat e mundshme, ishin disa nga idetë kryesore të cilat u përcollën në këtë simpozium, me pjesëmarrjen e liderëve të lartë fetarë në Ballkan si dhe studiuesve të njohur nga: Turqia, Franca, Gjermania, Kosova, Bullgaria, Maqedonia etj. Replika rreth ngjarjeve të ndryshme por edhe ide interesante të

përcjella, e bënë akoma më frytdhënës këtë event si në pikëpamje të historiografisë, ashtu edhe doktrinatorë, duke ndriçuar kështu vetë rrjedhat e tarikati brenda Islamit.

Ka qenë Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili falënderoi të ftuarit e pranishëm këtë simpozium, duke u kujtue se ndarja e ideve, në çdo rrafsh qofshin ato, e afron fenë me problematikat e kohës, në përpjekje për t'u afruar njerëzve, shpresa dhe guxim. Ai pastaj ka uruar studiuesit e huaj duke e parë kontributin e tyre jo thjeshtë në rrafshin bektashian por më gjerë, në ballafaqimin e komuniteteve të besimtarëve me sfidat. Më tej, Kryegjyshi Botëror vijoi:

Të nderuar vëllezër të mijë, klerikë dhe besimtarë

në Ballkan, he sfidat



bektashianë të ardhur nga trevat shqiptare!

Kam privilegjin dhe kënaqësinë e veçantë t'ju falënderoj të gjithëve që keni ardhur sot të ndajmë së bashku ide dhe mendime për të shkuarën, të sotmen dhe të nesërmen e tarikatit bektashian, ndaj më lejoni t'ju falënderoj dhe uroj: Paçi kurdoherë fat dhe mbarësi ju dhe familjet tuaja!

Zoti i Lartë, imamët tanë, dervishët dhe baballarët bektashinj, ju qofshin pranë në çdo rrahje të zemrës suaj!

Është me të vërtetë shumë domethënës fakti që, Selia e Shenjtë Bektashiane në Tiranë, ndonëse përmes përgjegjësive të mëdha, ndonëse përmes ngjarjesh, ndonëse përmes privacionesh social dhe ekonomikë, ka

gjetur mundësinë që çdo pranverë, në prag të festimeve të Sulltan Novruzit, të ditëlindjes së Imam Aliut, të organizojë evente të tillë që i shërbejnë jo thjeshtë edukimit tonë, por edhe kujtesës historike bektashiane. Ne kemi qenë dhe mbetemi të vetëdijshëm se tarikati të cilit i përkasim, ndonëse ka zënë fill tetë shekuj më parë, ka ecur përmes shtratit

të vet fetar, doktrinor dhe zakonor, duke u pasuruar në vende dhe kombe të ndryshëm, duke u zgjeruar me ujërat e kthjellëta të mistikës islame, për t'u derdhur në detin e pafund të devocionit ndaj Krijuesit dhe dashurisë njerëzore.

Ne gjithashtu jemi po kaq të vetëdijshëm se tarikati bektashian në viset e Ballkanit, i sendërtuar qysh në



Ne gjithashtu jemi po kaq të vetëdijshëm se tarikatit bektashian në viset e Ballkanit, i sendërtuar qysh në shekullin e 13-të, ka mundur të fitojë territore shpirtërorë të pastër, vetëm e vetëm nëpërmjet ndjenjave të kulluara njerëzore e fetare, që ushqejnë dashuri pa dallim race, ngjyre apo etnie. Si një urë bashkimi me themele në shpirtat e besimtarëve, bektashizmi ka mundur të ndikoj në të mirë të situatave etnike, jo thjeshtë në kontekstin fetarë, por edhe në filozofinë e moralit njerëzor. Teqetë bektashiane në ish-Jugosllavi, Rumani, Bullgari, Malin e Zi, Kosovë, Maqedoni Veriore, Greqi etj, ishin vatra vëllazërimi, ku besimi në Zot udhëhiqej kurdoherë nga ideja e të qenit shtëpi shprese për të gjithë, ku klerikët bektashianë, përveç urtësisë proverbiale të Haxhi Bektash Veliut, përçuan vetëm mirësi dhe paqe. Ne sot ndjehemi krenarë sepse edhe në viset shqiptare, tarikatit bektashian erdhi e hodhi rrënjë përmes urtësisë dhe përvuajtjes. Historiografia ballkanase por edhe më tej, kanë dëshmuar prej kohësh se bektashizmi në Shqipëri ka qenë aktiv jo thjeshtë në perceptimet dhe lëvizjet doktrinale të tij, por edhe në identifikimin e frymës së tij me lëvizjet nacionale. Është fakt i pamohuar se teqetë bektashiane në viset shqiptare, sidomos në shekullin e 19-të dhe në fillim të shekullit 20-të, ishin shndërruar në fole për mësimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe, ashtu sikundër dihet tanimë se qindra dervishë e baballarë tanët, u flijuan në lëvizjen tonë kombëtare, të nisur nga deviza madhore se "Pa atdhe, nuk ka fe!".

shekullin e 13-të, ka mundur të fitojë territore shpirtërorë të pastër, vetëm e vetëm nëpërmjet ndjenjave të kulluara njerëzore e fetare, që ushqejnë dashuri pa dallim race, ngjyre apo etnie. Si një urë bashkimi me themele në shpirtat e besimtarëve, bektashizmi ka mundur të ndikoj në të mirë të situatave etnike, jo thjeshtë në kontekstin fetarë, por edhe në filozofinë e moralit njerëzor. Teqetë bektashiane në ish-Jugosllavi, Rumani, Bullgari, Malin e Zi, Kosovë, Maqedoni Veriore, Greqi etj, ishin vatra vëllazërimi, ku besimi në Zot udhëhiqej kurdoherë nga ideja e të qenit shtëpi shprese për të gjithë, ku klerikët bektashianë, përveç urtësisë proverbiale të Haxhi Bektash Veliut, përçuan vetëm mirësi dhe paqe. Ne sot ndjehemi krenarë sepse edhe në viset shqiptare, tarikatit bektashian erdhi e hodhi rrënjë përmes urtësisë dhe përvuajtjes. Historiografia ballkanase por edhe më tej, kanë dëshmuar prej kohësh se bektashizmi në Shqipëri ka qenë aktiv jo thjeshtë në perceptimet dhe lëvizjet doktrinale të tij, por edhe në identifikimin e frymës së tij me lëvizjet nacionale. Është fakt i pamohuar se teqetë bektashiane në viset shqiptare, sidomos në shekullin e 19-të dhe në fillim të shekullit 20-të, ishin shndërruar në fole për mësimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe, ashtu sikundër dihet tanimë se qindra dervishë e baballarë tanët, u flijuan në lëvizjen tonë kombëtare, të nisur nga deviza madhore se "Pa atdhe, nuk ka fe!". Emrat e këtyre klerikëve, sot e në çdo kohë, do të ndriçojnë udhën tonë drejt përsosmërisë njerëzore, drejt paqes universale. Një homazh i thellë, shkon sot për myrshidin tonë, të shtrenjtin Haxhi Dede Reshat Bardhi, pa kontributin dhe frymën e të cilit, vështirë se mund të kishim ringritur besimin bektashian në lartësitë botërore të sotme.

Motra dhe vëllezër!

Pavarësisht se çfarë kemi arritur dhe çfarë synojmë të arrijmë në lartësinë e përgjegjësisë të Qendrës Botërore Bektashiane, ne jetojmë në një Shqipëri plot halle dhe vështirësi, përpara të cilave nuk mbyllim dot sytë, edhe në ditë të tilla të bekuara marsi.

Në vijimësi ne u jemi drejtuar faktorëve politikë të Shqipërisë, të ulen si në kafeohakët e teqeve, të dëgjojnë njeri-tjetrin, të pranojnë fjalët e mira dhe jo të tilla, të mendohen e pastaj të dalin në popull të flasin. Unë personalisht gjykoj se nëse nuk udhëhiqet nga dashuria për kombin, asnjë lloj politike nuk është e mjaftueshme, sado të bukura të jenë deklaratat, sepse realiteti që po kalojmë është i trishtë dhe i vështirë. Por edhe përballë këtij realiteti, teqetë në Shqipëri përcjellin vetëm paqe dhe shpresë.

Ndërkaq, jemi të bindur se çdo kontekst fetar shpreh marrëdhëniet dhe lidhjet e ngushta të tij, me realitetet e mbushura plot mllefe të verbër. Ngjarja e para disa ditëve, ku në Zelandën e Re humbën jetën 50 besimtarë myslimanë, duke falur namazin, prej dorës së një terroristi është jo thjeshtë tragjike, por edhe e frikshme. Duke u lutur për shpirtat e të vvarëve në xhami, ne bektashinjtë e kudo ndodhur në botë, dënojmë fuqishëm këtë akt makabër dhe bashkohemi në pikëllimin e myslimanëve të botës. Ne kemi ardhur të ndryshëm në këtë jetë, sepse i tillë qe



Pavarësisht se çfarë kemi arritur dhe çfarë synojmë të arrijmë në lartësinë e përgjegjësive të Qendrës Botërore Bektashiane, ne jetojmë në një Shqipëri plot halle dhe vështirësi, përpara të cilave nuk mbyllim dot sytë, edhe në ditë të tilla të bekuara marsi.

Në vijimësi ne u jemi drejtuar faktorëve politikë të Shqipërisë, të ulen si në kafeoxhakët e teqeve, të dëgjojnë njeri-tjetrin, të pranojnë fjalët e mira dhe jo të tilla, të mendohen e pastaj të dalin në popull të flasin. Unë personalisht gjykoj se nëse nuk udhëhiqet nga dashuria për kombin, asnjë lloj politike nuk është e mjaftueshme, sado të bukura të jenë deklaratat, sepse realiteti që po kalojmë është i trishtë dhe i vështirë. Por edhe përballë këtij realiteti, teqetë në Shqipëri përcjellin vetëm paqe dhe shpresë.

Ndërkaq, jemi të bindur se çdo kontekst fetar shpreh marrëdhëniet dhe lidhjet e ngushta të tij, me realitetet e mbushura plot mllafe të verbër. Ngjarja e para disa ditëve, ku në Zelandën e Re humbën jetën 50 besimtarë myslimanë, duke falur namazin, prej dorës së një terroristi është jo thjeshtë tragjike, por edhe e frikshme. Duke u lutur për shpirtrat e të vvarëve në xhami, ne bektashinjtë e kudo ndodhur në botë, dënojmë fuqishëm këtë akt makabër dhe bashkohemi në pikëllimin e myslimanëve të botës. Ne kemi ardhur të ndryshëm në këtë jetë, sepse i tillë që vullneti i Zotit. Dhe ky vullnet, do të jetë kurdoherë i pranishëm në botë, duke na dhënë forca të bashkohemi dhe askurrë të mos trishtohemi, përballë situatave të tilla, sepse për ne, janë paqja dhe mëshira hyjnore, jo luftërat. Zoti u bekoftë të gjithëve!

vullneti i Zotit. Dhe ky vullnet, do të jetë kurdoherë i pranishëm në botë, duke na dhënë forca të bashkohemi dhe askurrë të mos trishtohemi, përballë situatave të tilla, sepse për ne, janë paqja dhe mëshira hyjnore, jo luftërat. Zoti u bekoftë të gjithëve!

Ndërsa Kryetari i Bashkësisë Islame të Malit të Zi, Reiz Ulema Refat Fejzić, pasi falënderoi organizatorët për ftesën, u ndal në kontekstin e sotëm të zhvillimeve fetare në Ballkan, duke tymuar së tepërmi rolin e pazëvendësueshëm të Selisë së Shenjtë Bektashiane, sidomos këto vite të postdiktaturave që kaloi krejt Europa Lindore. Ai tha midis të tjerave se urtësia dhe mirësia që shpërndajnë tarikatet e kanë bërë Islamit më shprehës dhe më të vëmendshëm ndaj ngjarjeve, ku padyshim bektashizmi ka përvojat e veta jetësore. Ai e tymoi simpoziumin jo thjeshtë për trajtesat historike, por edhe për frymën e bashkëjetesës fetare që përcillet në ditët e sotme.

Më tej ka qenë Kryetari i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, z. Ajni Sinani, që mori fjalën duke falënderuar Selinë e Shenjtë Bektashiane për misionin historik që ka marrë përsipër, duke udhëhequr këtë tarikat për gati një shekull dhe duke sintetizuar përpjekjet e komunitetit të këtij besimi, kudo ku ata ndodhen, në çdo kontinent. Ne jemi të bindur, u shpreh ai, se nën udhëheqjen e Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryegjyshata Botërore po hedh hapa të sigurt në konsolidimin organizativ të saj, duke i dhënë kurdoherë vendin që i takon vëllazërisë fetare jo vetëm në Shqipëri, por dhe në Kosovë dhe në viset shqiptare në Mal të


Zi dhe Maqedoninë Veriore, sepse filozofia e unitetit dhe bashkimit është në të vërtetë filozofia e vetë Islamit.

Edhe Zëvendëskryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, u ndal në modelin harmonik të simpoziumeve të tillë ku historia nuk shihet si qëllim në vetvete, por vihet në kuptimin më të mirë, në shërbim të zhvillimeve fetare. Ai u ndal paskëtaj në harmoninë shekul-



lore fetare të shqiptarëve, e cila përveçse një vullnet i Zotit, ka qenë dhe mbetet një lëvizje e menduar e komuniteteve tradicionale fetare drejt identiteteve përkatës duke iu shmangur në ndonjë rast ndikimeve të huaja, të cilat kanë të bëjnë sa me radikalizmit, aq edhe me politizimin e fesë. Dhe në mënyrë të veçantë, në këto kontekste, roli i Selisë së Shenjtë Bektashiane ka qenë i madh, jo thjeshtë në aspektin propagandistik, por sidomos në praktikën zhvillimore të denja për çdo besimtar mysliman, përfundoi ai.

Presidenti i Shtëpisë Sufi të Francës, Sheik Abdel Afid, përveç të tjerave, i drejtoi një falënderim të veçantë Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë dhe Kryegjyshit Botëror, lidhur me veprimtarinë “Ditët e Kulturës Bektashiane” që organizohet në Paris në çdo 25 maj. Ai tha tekstualisht se “kjo kulturë identitare bektashiane, në zemër të Parisit, na kujton të gjithëve ne, ndjekësve të tarikateve të ndryshëm të Islamit, se duhet të jemi sa më pranë njeri-tjetrit, nën



mësimet e Kuranit të Lartë, nën shembujt e Profetit dhe Imamëve, duke i dhënë botës së sotme më shumë shpresë dhe paqe”.

Ndërsa Zëvendëskryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Andis Seferi, pasi falënderoi organizatorët tha se simpoziume të tillë ndërkombëtarë, i bëjnë nder jo thjeshtë komunitetit bektashian, por krejt asaj klime të mrekullueshme fetare që ne duam të jetë e pranishme në çdo ditë dhe në çdo metër të Tiranës. Kryeqyteti dhe bota jonë intelektuale dhe akademike, kanë shumë gjëra për të marrë dhe për të dhënë me komunitetet tanë tradicional, përfundoi ai.

Panelin e dytë, atë të kumtesave, e çeli Prof. Dr. Arhan Ardas nga Gjermania, i cili do të jepte mendimet e tij mbi shtyllat kryesore që mbajnë kaq të gjallë dhe imponues tarikatin bektashian. Midis të tjerave ai tha: “Posaçërisht, kur flasim për tarikatin bektashi, kemi parasysh jo vetëm harmoninë e rritjes brenda tij, por sidomos influencën paqësore që ky besim përcjellë tek fetë e tjera.

Tarikati bektashi ka prejardhjen prej Haxhi Bektashit dhe roli i të cilit në jetën shpirtërore dhe kulturore të Turqisë së vjetër, madje edhe në një të tretën e parë të këtij shekulli, ka qenë vërtet i konsiderueshëm përkundër persekutimeve të mëdha. Por tarikati i është përmbajtur ezoterizmit rigoroz që vështirëson studimin e mësimin të tij, në të cilin hasim gjurmë të fuqishme të neoplatonizmit dhe në themel kundrimin duodecimal shi'it të gjërave. Bektashizmi është një tarikat, i cili veç të tjerave ka lindur, për të ngërthyer më të mirat e islamizmit, budizmit dhe krishtërit në pikëpamjen teologjike. Nga na tjetër, ajo u tregua e hapur për mendimin më përparimtar filozofik të kohës dhe e vuri dijen dhe atdhetarizmin në themel të saj. Panteizmi (Zoti gjendet gjithkund në tokë, e në natyrë) është një nga veçantitë e kësaj feje. Prandaj edhe Naim Frashëri, si një bektashi i madh, u këndonte bukurive të natyrës së Shqipërisë duke e ndërthurur mjeshtërisht fenë ku besonte, me atdhedashurinë. Bektashizmi shqiptar ka nxjerrë figura të shquara që shkruanë pasurinë dhe jetën për Shqipërinë: Naim, Sami, Abdyl e Mithat Frashëri, Gjysh Ali Gjyrokastër, Aqif Pashë Elbasani, Hafëz Ali Korçën, Syrja Vlorën, Baba Rexhebin, Faik Konicën, Musine Kokalarin e qindra patriotë dijetarë e mendimtarë të tjerë. Islami u përhap në tokat shqiptare jo vetëm në variantin e vet kryesor, sunit, por edhe në formën e tarikateve të ndryshme, siç ishin bektashizmi, halvetizmi, rufaizmi etj. Dëshmi të pranishme të këtyre tarikateve mistike në territorin shqiptar janë teqetë e ndërtruara në një numër vendbanimesh. Midis tarikateve islamike në fjalë, bektashizmi fitoi një popullaritet dhe shtrirje të konsiderueshme në viset shqiptare.

Edhe Kruja qyteti historik shqiptarë është e lidhur ngushtë jo vetëm me simbolin e luftës së Skënderbeut por më vonë edhe si një kështjellë myslimane e lidhur me kultin e Sari Salltikut predikoi islamit në viset shqiptare para ardhjes së Osmanëve, ishte në thelb të interpretimeve bektashi. Në teqenë e Krujës ruheshin kujtime për Skënderbeun, ndërsa bektashinjtë theksonin se Skënderbeu, i rritur në oborrin e Sulltanit dhe i lidhur me trupat e jeniçerëve, përpara se


të kalonte në besimin katolik, duhet të ketë qenë mysliman bektashi. Njëri ndër udhëheqësit e njohur të bektashinje shqiptarë, baba Ali Tomorri, në librin e tij “Historia e bektashinje”, e sheh luftën e Skënderbeut si pjesë të betejës së parë të bektashinje kundër sultanëve osmanë. Të tilla mite, si ata të krijuar më parë nga ideologjia e bektashinje në lidhje me politikën osmane, erdhën duke u përdorur gjithnjë e më shumë, sa më tepër që karakteri i hershëm kombëtar, që zakonisht i vishej politikës së Skënderbeut dhe asaj të Ali Pashës, si dhe nevoja për të nënvizuar karakterin e hershëm të krishterë dhe për të zvogëluar karakterin e mëvonshëm mysliman, përputheshin me dënimin e ashpër të fesë islame në kuadrin laik të shtetit të pavarur shqiptar, ndërkohë që për bektashinjtë u ruajt një përfytyrim si për një rrymë fetare liberale dhe nacionaliste. Ndoshta po për këtë arsye më vonë do të mendohet në ndonjë rast se si mbreti Zog ishte me prejardhje nga bektashinjtë. Kësisoj,

Presidenti i Shtëpisë Sufi të Francës, Sheik Abdel Afid, përveç të tjerave, i drejtoi një falënderim të veçantë Selisë së Shenjtë Bektashiane në Tiranë dhe Kryegjyshit Botëror, lidhur me veprimtarinë “Ditët e Kulturës Bektashiane” që organizohet në Paris në çdo 25 maj. Ai tha tekstualisht se “kjo kulturë identitare bektashiane, në zemër të Parisit, na kujton të gjithëve ne, ndjekësve të tarikateve të ndryshëm të Islamit, se duhet të jemi sa më pranë njeri-tjetrit, nën mësimet e Kuranit të Lartë, nën shembujt e Profetit dhe Imamëve, duke i dhënë botës së sotme më shumë shpresë dhe paqe”.


njëlloj sikurse paraardhësit e tyre në perandorinë osmane, bektashinjtë do të ripojnë ndihmesën e tyre në ndërtimin e shtetit shqiptar dhe do të paraprijnë kështu përfitimet politike. Mirëpo duhet ditur se bektashinjtë janë shumë të hershëm në Ballkan e viset shqiptare. Ata kanë luajtur rol në paqen brenda tarikateve islame por dhe në paqen e tolerancën ndërmjet besimeve tjera. Besimtarët praktikantë të çfarëdo lloj feje në botë, duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të parandaluar, që feja të përdoret si burim konflikti. Në fakt, përdorimi i gjuhës dhe simboleve fetare mund të bëhen një nga armët më të fuqishme strategjike në një konflikt. Historia na tregon se të gjitha kulturat e mëdha janë zhvilluar përmes shkëmbimeve me kulturat e tjera, përmes reciprocitetit të këtij shkëmbimi dhe jo përmes shtypjes dhe përbuzjes. Kurani shpall se një nga objektivat



e krijimit është që popujt e ndryshëm të tokës të njihen ndërmjet tyre. Ne jetojmë në një botë që karakterizohet nga lëvizjet e popullsisë dhe përzierje kulturash të pashembullt. Në këtë kuptim, ne jemi të ndërvuarur dhe kemi



përgjegjësi të përbashkët për mirëqenien e tërë botës. E kështu besimi fetar mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë periudhë kritike. Diversiteti është pasuria e kësaj bote të jemi të ndryshëm dhe ti besojmë një Zoti. Kulturat i japin fesë gjuhën e tyre dhe fetë një kuptim të fundmë





çdo kulture. Në këtë kuptim, pa pranimin e pluralizmit dhe pa respektimin e dallimeve nuk mund të ketë paqe. Por, as paqja dhe as feja nuk mund të reduktohen në koncepte unike dhe të ngurta, ashtu si tërë eksperiencia njerëzore nuk mund të shprehet vetëm përmes një gjuhe.

Rol të madh luajti edhe teqeja bektashiane në Gjakovë, themeluar në vitin 1790. Ndonëse sot kjo teqe është i vetmi objekt i këtij lloji në Kosovë, njëherit edhe seli e Gjyshitës së Kosovës, u dogj e u rrënuar me themel nga forcat serbe më 1999. Maksima e bektashizmit është: "Pa atdhe nuk ka fe!". Baba Mumin Lama tregon se: "Është shumë e vërtet që kemi kërkuar atdheun ma s'pari. Po ndalem vetëm në luftë e fundit të 99-tës kur Teqja u dogj. . . U dogj, pse nuk patë atdhe! Sikur ta kishim atdheun tonë". Teksa rrëfen Baba Mumin Lama, fjalët e fundit i mbeten në grykë. Teqja e Bektashive me këtë rast humbi edhe bibliotekën me mijëra libra e dhjetëra dorëshkrime. "Ndër to edhe 58 dorëshkrime, një dorëshkrim ka pas 100 faqe por ka pas dorëshkrime me 400 faqe. Të gjitha janë djegur!" Por, tempulli i rrënuar para tetë vjetësh, tashmë është renovuar me ndihmën e qeverisë së Kosovës dhe sërish ka hap dyert për besimtarët. Kjo e lumturon udhëheqësin shpirtëror dhe atdhetar i cili thotë: "Ne ishim të pushtuar. Tash kemi atdheun tonë dhe tash prapë kemi teqe!" . "Bektashizmi

njihet si udhë mistike islame që merret me përsosmërinë shpirtërore të njeriut. Bektashizmi i ka rrënjët në Kuran dhe në mësimet e Profetit Muhamed e të 12 imamëve"-ka shkruar vite më parë baba Rexhebi në SHBA.

Selia e Shenjtë në Tiranë dhe teqeja bektashiane në Gjakovë organizojnë shpesh aktivitete kombëtare dhe fetare aty kanë marrë pjesë dhe marrin pjesë hoxhallarë e priftërinj, studiues si dhe udhëheqës të politikës ekonomisë e njësisve lokale ku si teqe gjithmonë i ka shërbyer atdheut e besimit e promovimit të paqes. Janë prekur shumë ide dhe probleme në këto veprimtari si në aspektin historik ashtu dhe në realitetin që po kalojmë. Sigurisht tarikati bektashian, sikundër të gjithë fetë dhe besimet e sotme, kanë edhe sfida për t'u përballur në rrafshin doktrinar apo praktik. Besojmë të gjithë se në këto sfida, bektashinjtë do të ecin në gjurmë të të aprëve të tyre, duke vënë në pah esencën nacionale tonën.

E ngjitur me Gjakovë pikërisht në Malësinë e Gjakovës vendlindja ime asht ni maje e cila fsheh shumë mistere e bekime e lashtë sa vet njeriu. Mbi 2500 mbi nivelin e detit, Maja e Shkëlzenit Tropojë si panoramë mban trupin e Sari Salltikut ku misioni i ti ishte ndriçimi i botës me fenë e bekuar islame si bektashi i dedikuar për paqe dhe dashuri. Ku edhe sot shumë njerëz e vizitojnë dhe kjo zonë ka shumë ndjekës të bektashizmit dhe tarikateve mistike të cilët ndikuan te populli në gjendjen e tyre shpirtërore duke i stabilizuar e qetësuar edhe kur ishte skamja e madhe por edhe kur kishte regjime e pushtime e shtypje u jepnin popullit shpresë për ditë më të ndritura e të bekuara.

Ndërsa Presidenti i Shtëpisë Sufi të Francës, Sheik Abdel Afid, do të kumtonte rreth mistikës dhe lirisë së besimit, si një raport ideal jo thjesht doktrinar, por sidomos në përshatje me rrethanat kohore dhe historinë e Islamit. Brenda këtyre hulumtimeve personale, duke u ndalur sidomos në veprën e Imam Aliut a.s., Sheiku vijoi: "Në botën që na rrethon, vëmë re se ekuilibri që i lejon kombet e ndryshme të jetojnë në paqe, mbetet i brishtë. Ekstremet zhvillohen, në mjaft raste, në sferën politike dhe në atë fetare. Atëherë, cila është zgjidhja? Sigurisht nuk ka zgjidhje të mrekullueshme, por them se respektimi i feve dhe besimeve të ndërsjellta si dhe një etike të caktuar, kufizon mundësitë e kaosit që disa grupe të dëmshme do të dëshironin të shihnin në këtë apo atë pjesë të botës. Shumica e udhëve sufi, në genealogjinë e tyre shpirtërore fillojnë me Imam Aliun, përveç rrugës sufi të nakshibendinjve që fillon me Profetin, paqja qoftë me të, nëpërmjet Abu Bakr As-Saddik.

Nuk ka shumë literaturë për këtë të fundit, mësimi i të cilit ishte tepër shembullor dhe sidomos ajo që ka thënë Profeti: "Gjithçka në gjoksin tim, e kam hedhur në gjoksin e Abu Bekrit", është konsideruar si dera e bujarisë, megjithatë, Imam Aliu, që konsiderohet si dera e shkencave, ka lënë pas shumë thënie, disa prej të cilave janë studiuar dhe janë burim i diturisë për shekuj me radhë si në qarqet sunite dhe ato shiite, dallimi ndërmjet të cilëve nuk është përcaktuar gjithmonë në rrjedhën e historisë. Ne dimë, në fakt, se shumë shkencëtarë sunni kanë lindur në territoret e Iranit

të sotëm dhe shumë rrugë sufi ose turuks, kanë treguar respekt e nderim për familjen e Profetit dhe sidomos për hazreti Ali e hazreti Fatima dhe fëmijët e tyre, Hassan dhe Hysen, Zoti i bekoftë të gjithë. Në memorien kolektive, Imam Aliu mbetet një figurë jo vetëm e respektuar, por e admiruar në të gjithë botën myslimane, nga Indonezia në Marok dhe nga Afrika e Jugut në Ballkan.

Prova është se shumica e xhamive të ngritura gjatë sundimit të dinastisë osmane, përveç emrave të katër kalifëve, shpesh ka emrat e Hasanit, Hysenit dhe Fatimes. Asnjë forcë e bindjes islame nuk mund të injorojë vendin e veçantë të familjes së Profetit në historinë e Islamit. Vetë Pejgamberi gjatë jetës na tregoi për privilegjet e anëtarëve të familjes së tij, por fama e tyre u vërtetua në vitet dhe në shekujt në vijim me praninë e Imamëve, të cilët gjithashtu janë respektuar dhe konsideruar si qenie të jashtëzakonshme, si në botën shiite, ashtu edhe në atë sunite.

Mësimet e Imam Aliut dhe sunizmit ndërlidhen në udhën sufi nakshbandi dhe bektashi. Lidhja e tyre është me Jusuf Al Hamadanin (1140), i cili ishte mjeshtër i Ahmed Jaseviut (1093-1166) dhe ky i fundit kishte një ndikim thelbësor te alevitet, të cilët janë të lidhur drejtpërdrejt me udhën bektashiane të themeluar nga Haxhi Bektashi, e cila mund të lexohet në burime të mirëfillta arkivore osmane dhe turke.

Haxhi Bektash Veliu është një nga figurat më të rëndë-



sishme të islamit turkmenistan në Anadoll. Burimet epike që bazohen në jetën e tij e përcaktojnë si pasardhës “të mençur” të Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të), «sayyid» që do të thotë se rrjedh biologjikisht nga familja e bekuar e Profetit tonë. Babai i tij, Ibrahim, ishte pasardhës i Musa Qazimit, një nga imamët e Ehli-Bejtit, i afërm i profetit. Babai i Haxhi Bektash Veliut, Ibrahim Beu, ishte një bej fisnik nga komuniteti turkmen i Khorasanit.

Sipas të dhënave epike, Haxhi Bektash Veliu u formua nga sufiu Lokman Perende i famshëm dhe, pas rekomandimit të këtij të fundit, nga Ahmed Jasevi. Duke pasur parasysh se Ahmed Yasavi vdiq në moshë të madhe, ka mundësi që ai të ishte mësues i Haxhi Bektash Veliut. Përveç kësaj, rrjedh se ata kishin një lidhje edukative përmes Lokman Perende.

Haxhi Bektash Veliu ishte një dijetar që emigroi nga Azia Qendrore në Anadoll pas pushtimit mongol. Ahmed e kishte dërguar në Anadoll, si një nga dishepujt e tij. Haxhi Bektashi e përm-bushi detyrën e tij të pelegrinazhit duke shkuar në Mekë pas Ahmed Jaseviut dhe mori titullin “Haxhi”. Gjatë rrugës, ai vizitoi Qerbalanë, para se të udhëtonte për në Anadoll. Haxhi Bektash Veliu arriti në Sulucakarahoyuk (tani Haxhi Bektash), në lagjet e ftohta të turkmenit Chepni, ku u prit nga Kadinxik Ana. Ai bëhet bari në fshat për të siguruar nevojat e tij.

Në të njëjtën kohë, ai filloi të njihet në Anadoll për cilësitë e tij të mençurisë. Ndërtoi prehtoren e parë të dervishëve, të cilat më pas u përhapën dhe u quajtën teqë bektashiane. I njohur



midis njerëzve të mençur të rajonit dhe popullit, Haxhi Bektash Veliu u bë dijetari më i madh i Anadollit dhe pati një ndikim të madh te turkmenët në Sulucakarahoyuk (Haxhi Bektashi i sotëm). Ai zhvilloi marrëdhënie të ngushta me të krishterët e trevës së Kapadokisë dhe përgatiti bazat për kthimin e tyre në Islam. Haxhi Bektashi dërgoi pasuesit e tij në të katër anët e Anadollit. Krahasuar me sufite të kohës së tij, ai ishte një mjeshtër dervish, i cili i respektoi parimet e islamit të moderuar e të sunizmit dhe një nga përfaqësuesit më të mëdhenj të islamit në Anadoll.

Në një vepër tjetër Imam Aliu na thotë: “Nuk ka një vend që është më i mirë se një tjetër: vendi më i mirë është ai që ju pranon dhe ju përkrah”. Kjo fjalë e urtë na tregon se gjithkush duhet të dojë në të njëjtën kohë të dy vendet, të tijin, por edhe vendin pritës në rast emigrimi!

Mësimet e tij dhe mësimet e Haxhi Bektashit, Rumiut, Shah Bahaudin Nakshibendiut, Ahmed Al Jaseviut dhe Yusuf Al Hamadanit, e kanë burimin e tyre në tekstin Kur’anor, në Kuranin e Ndritur, ku në suren Al Huxhurat lexohet: “O qenie njerëzore! Ne ju krijuam nga një mashkull dhe një femër dhe ju bëmë kombe e fise, që të njihni njëri-tjetrin. Më i miri mes jush me Allahun, është më i devotshmi. Allahu është sigurisht i Gjithëdijshmi”. [Kur’an 49: 13]

Vlerësime të mrekullueshme ka bërë Imam Aliu edhe për Kuranin e ndritur. Diku, ai thotë:

“Dijeni se Kur’ani është këshilltari që nuk mashtron, udhëzuesi që nuk gabon, dhe folësi i cili nuk gënjen”.

“Ky Kur’an është i mirë në pamje dhe i thellë në përmbajtje. Mrekullitë e sekretet e tij janë të pafundme dhe errësira shpërndahe vetëm prej tij”.

“Askush nuk e ka vizituar këtë Kur’an pa shkuar me një plus ose minus: më shumë udhëheqje dhe më pak verbëri”.

“Mësoni Kur’anin, sepse është pranvera e zemrave dhe shërohuni nga drita e tij, sepse është shërimi i shpirtit”.

“Mësoni Kur’anin, është më i miri i fjalëve; thellohuni

në të, është pranvera e zemrave; kuroni sëmundjet tuaja me dritën e tij, sepse është shërimi i shpirtit; lexojeni atë me saktësi dhe me kujdes, sepse është më i dobishmi ndër tregimet. Dhe dijeni se dijetari që zbaton diçka tjetër përveç shkencës së tij, është si injoranti i hutuar që nuk zgohet nga injoranca, apo më keq akoma, se dëshmitë kundër tij do të jenë më të forta, psherëtima (dita e gjykimit) më e thellë dhe më e dënueshme nga Allahu”.


Por më e mira nga të gjitha këto mësimet janë letra të vdekura, nëse ato nuk zbatohen nga personalitete të gjallë dhe duke u dhënë shembull njerëzve të sotëm. Shembujt e dhënë nga sheiku Nazim Al Hakani i udhës sufi nakshibendi, në të cilën unë jam i lidhur si përfaqësues në Francë, si dhe nga baba Mondit ynë i dashur i udhës bektashi, të cilët janë takuar me Papën dhe kanë dhënë një shembull të tolerancës dhe të bashkëjetesës, jo vetëm për dishepujt e tyre, por për të gjithë botën myslimane. Predikimet e tyre i udhëheqin gjithmonë besimtarët dhe njerëzit në përgjithësi drejt bashkëjetesës dhe harmonisë ndërjetare.

Unë falënderoj ngrohtësisht miqtë e mi, Kryegjyshin Botëror të Bektashinjve, Hirësinë e tij Haxhi Dede Edmond Brahimaj, dhe shpresoj se do të kemi mundësinë për të punuar krah për krah për mirëqenien e njerëzimit.

Nga ky simpozium dëshiroj t’i jap bekimin Shqipërisë, këtij vendi të bukur, të cilin e zbulova falë mikut dhe vëllait tim Enris Qinami. Mëshira dhe drejtimi i Perëndisë rrjedhtë në zemrën e baba Mondit dhe nga zemra e tij në atë të të gjithë shqiptarëve.

Mirëqenia dhe paqja e përfshifshin këtë vend të bukur, Shqipërinë dhe pranoni të nderuar miq përshëndetjete sheikut tonë të dashur, djalit e pasardhësit të Mevlana Sheikh Nazim, Mevlana Sheikh Mehmet Al Rabbani dhe vëllait të tij, Sheik Bahauddin Adil.

Ju falenderoj edhe një herë dhe fillimi e



fundi më i bukur për të gjithë ne dhe lutja më e bukur është Surat Al Fatiha!

Vend të veçantë në këtë event do të zinte edhe jubileu i 65 vjetorit të themelimit në SHBA të teqesë së parë bektashiane nga Hirësia e Tij, baba Rexhebi. Studiuesja e njohur Blerina Kuqi, u ndal sidomos në vlerat e mëdha fetare dhe kombëtare të kësaj teqeje. Midis tw tjerave ajo tha: Mendoj se është fat dhe privilegj i veçantë të jem e pranishme në këtë event bektashi- andhe njëherazi të sjell për të pranishmit hulumtimet e mia personale rreth teqesë së baba Raxhepit, të parës teqe bektashiane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila përveç misionit hyjnor të saj (shpërndarjes së besimit në Zot dhe në idetë e Haxhi Bektash Veliut) qysh nga dita e parë e çeljes dhe deri sot vijon të jetë një vatër e ngrohtë atdhetarie. Sigurisht në këtë udhë, teqeja bektashiane në Detroit, do të ecte në gjurmët e simotrave të saja në Shqipëri, të cilat në mënyrë të veçantë në shek. XIX- XX, ishin karakollet e para të lëvizjes kombëtare për lirinë e ëndërruar.

Është e njohur tanimë profecia e dalë prej Haxhi Bektash Veliut, i cili gati tetë shekuj më parë, përmes urtësisë proverbiale shpalli se: "kur qiriri im të fiket në Lindje, do të ndizet në Perëndim". Ezoterizmi islam, si një thelb i dijes së tarikateve ka shoqëruar

zhvillimin e tyre në çdo hap. Shpeshherë, kanë qenë saktësisht këto "fshehtësi hyjnore" që udhëheqësit shpirtërorë kanë përcjellë tek ndjekësit e tyre me një siguri të paprecedentë. Do thërrisja në ndihmë për këtë qëllim ajetin kuranor që thotë "Ua ofruam amanetin e fshehtësive tona, qiejve, tokës dhe maleve. Të gjithë këta refuzuan pranimin, të gjithë u frikësuan. Por njeriu pranoi që ta marrë mbi vete këtë barrë. Ai ishte i fuqishëm dhe i pavetëdijshëm. Fjalët e tij do të vërtetoheshin me hapjen e teqesë bektashiane në Detroit, në një vend perëndimor, siç është Amerika.

Historia na mëson sesi ngjarjet përsëriten. Sot shumë studiues të bektashizmit bien dakord se lidhja e tij me jeniçerët, përbën shkakun kryesor të raprezaljeve otomane, në mënyrë të veçantë në fillimet e shek. XIX. Njëri prej tyre, Justin Mrcartly nënvizon mes të tjerave faktin se në vitin 1826 sulltan Mahmudi i sapoardhur në pushtet, kërkoi reformimin

trupës së jeniçerëve, pasie pati kuptuar se ata nuk do t'i kishte në krah. Raprezaljet e tij vranë me mijëra ndjekës të bektashizmit, por pa mundur dot të realizonte qëllimin që i kishte vendosur vetes, zhdukjen e besimit, i cili kërcënonte autokracinë e sulltanit. Të njëjtin fat do të kishin edhe ata klerikë bektashinj shqiptarë, të cilët dolën kundër ateizmit komunist dhe ideve të tij. Një ndër ta ishte edhe Baba Rexhepi. Për shkak të lidhjeve të ngushta të teqesë së Zallit në Gjirokastër me nacionalistët e Jugut të Shqipërisë, në nëntorin e vitit 1944, u largua nga vendi së bashku me burra të tjetër si Mit'hat Frashëri, Ali bej Këlcyra, Vehbi Ismaili, Hasan Dosti, Abaz Kupi etj, me idenë e vazhdimet të përpjekjeve për të luftuar instalimin e regjimit komunist, duke pasur përkrahjen e vendeve perëndimore. Pas disa vitesh të mbushura me peripeci të shumta, në vitin 1952 baba Rexhepi shkon në SHBA me shpresën e madhe të hapjes së teqesë së Haxhi Bektash Veliut edhe në këtë vend ku repektohen liritë fetare të çdo kombi dhe dinjiteti njerëzor. Teqeja e parë bektashiane në SHBA lidhet, pa më të voglin dyshim me kontributin e shkëlqyer të baba Rexhepit, i cili u mësua me ndjenjat më të kulluara të shqiptarizmit dhe bektashizmit nga baba Selim Gjirokastra.

Ekzistojnë dokumenta të shumta për grupin nismëtar për hapjen e teqesë. Këta shqiptarë, emigrantë ekonomikë kishin entuziazmin dhe dëshirën për të patur një objekt kulti të tarikatit të tyre. Një përskrim të saktë të asaj tabloje të viteve 1953-1954, në Detroit të shtetit të Michigan-it e ka bërë studiuesi i njohur, Xhevat Kallajxhi, njëherëzi edhe bashkëpunëtori i ngushtë i Baba Rexhepit. Së bashku me mbledhjen e ndihmave për gritjen e teqesë, grupi nismëtar u interesua edhe për të zbatuar deri në imtësi rregullat kanonike bektashiane. Ata i dërguan një lutje Baba Siri Çoçolit të teqesë së Kajros ku i kërkuan të dekretonte baba Rexhepin. Përgjigja prej tij nuk vonoi. Ai shkruante:



“Pikësëpari ju përgëzoj me gjithë zemër për iniciativën njerëzore dhe fetare që muartë, duke ngrehur një teqe në Amerikë, të parën teqe bektashiane në atë vend të lirë dhe të bekuar. Kjo vepër ju nderon, siç ju nderojnë edhe kaq e kaq vepra të tjera të ndritura, të kryera nga ju gjatë shumë vjetëve në fushën kombëtare, fetare dhe kulturore... Brenda në këtë letër po ju dërgoj dekretin e shenjtë për dorëzimin e dervish Rexhepit si baba, titullar i parë i teqesë bektashiane në qytetin e Detroitit të SHBA-së. Dervish Rexhepi i ka të gjitha cilësitë e duhura për të zënë postin e babait në atë teqe. Perëndia dhe Haxhi Bektashi qofshin kurdoherë me ju”.

Në kremtimin e 10 vjetorit të themelimit të teqesë baba Rexhepi, në fjalën e tij do të përcillte së pari respektin e thellë për blatimet më të sinqerta për popullin dhe shtetin amerikan, sepse në atë vend të bekuar, si të gjithë njerëzit e kombeve të tjera edhe shqiptarët jo vetëm siguruan jetësën, por gëzuan lirinë dhe përkrahjen e shtetit amerikan për të ushtruar lirisht besimin e tyre. Baba Rexhepi konstatoje me krenari se në Detroit ekzistonin tri faltore: kisha ortodokse, xhamia myslimane dhe teqeja bektashiane. Ai theksonte se ato ishin jo vetëm çerdhe ku shprehej vullneti i Zotit, por ishin njëkohësisht edhe simbole vllazërimi, të cilat u ngritën me ndihmën morale dhe materiale të shqiptarëve të Amerikës, pa dallim krahine dhe feje. Ligjëratën e tij do ta mbyllte me fjalët: “Dyert e teqeve bektashiane ishin kurdoherë të çelura për çdo njeri, shqiptar ose i huaj, pa dallim race, feje ose shkalle shoqërore. Shtëpia e Haxhi Bektashit është shtëpia e të gjithëve, ka thënë Naim Frashëri. Këtë traditë po ndjek edhe teqeja jonë, e cila i ka hapur dyert për këdo dhe si pasonjëse besnike e Haxhi Bektashit, predikon kurdoherë paqen, dashurinë, vllazërimin midis shqiptarëve dhe midis njerëzve.

Baba Rexhepi u përpoq gjithmonë për të siguruar sfondin e duhur intelektual dhe shpirtëror në vitet e para e të vështira të çeljes së teqesë. Tirana zyrtare e asaj kohe e kishte renditur këtë klerik në listën e gjatë të “armiqtë të partisë dhe të popullit”. Kjo nuk e ndali atë. Në Amerikë ai ruajti kontakte edhe me një figurë tjetër fetare, Fan Nolin, për të cilin kishte një respekt të veçantë. Këta dy klerikë u ritakuan pas më shumë se tri dekada, në Boston, në ceremoninë përkujtimore të vdekjes së Faik Konicës, në vitin 1952. Në bisedën që patën mes tyre baba Rexhepi kujton se si Imzot Noli çmonte dhe nderonte teqetë dhe klerikët bektashianë, rolin dhe veprimtarinë e tyre patriotike që në vitet e Rilindjes Kombëtare, si dhe veprimtarinë e tyre të palodhur në shërbim të forcimit e vllazërimit midis shqiptarëve. Imzot Noli i kishte shprehur dëshirën e madhe që

së shpejti edhe në Amerikë të kishte një teqe bektashiane. Dëshira u bë realitet duke përmbushur ëndrrat e shumë shqiptarëve. Vetë Noli e vizitoi atë madje dha edhe një kontribut financiar prej 500 dollarësh.

Me punën e palodhur fetare të baba Rexhepit dhe ndihmën e klerikëve të tjerë, teqeja e Detroitit erdhi duke u rritur e fuqizuar. Ajo mbante lidhje të rregullta jo vetëm me organizmat ndërkombëtarë në SHBA e Europë si dhe duke ndjekur me ndjeshmërinë më të mëdha ngjarjet në Shqipëri. Ai pati një korrespondencë të dendur me personalitete të ndryshme, me liderë politikë e fetarë duke dëshmuar jo vetëm autoritetin dhe prestigjin e teqesë, por edhe frymën që ajo shpërndante si një faktor uniteti dhe tolerance. Është me vlerë për t’u përmendur një fakt në këtë drejtim. Një grup ortodoksësh nga kolonia shqiptare në Stambolli dërguan Baba Rexhepit një letër, në dhjetor 1956, ku i kërkonin ndihmë, për gjetjen e një prifti ortodoks shqiptar nga kolonia shqiptare në Amerikë. Ata i shprehnin besimin e plotë në autoritetin dhe patriotizmin e tij për të zgjidhur një çështje të ndërlikuar që vinte në pikëpyetje veprimtarinë e tyre fetare si dhe i parashtronin rrezikun që i kanosej kësaj kishe ortodokse shqiptare, që të binte nën ndikimin e kishës greke, synimet e të cilës njiheshin fare mirë. “Këtë thirrje kombëtare, u lejuam t’ia drejtojmë hirësisë suaj më parë, që me patriotizmin e njohur, me prestigjin e math që gëzoni në të gjitha rrethet shqiptare në Amerikë, të bëhi interpret i kolonisë shqiptare të Stambolli, pranë çdo patrioti për të na dërguar një orë e më parë një misionar prift, që shqiptarisht do të mbetet i paharruar, të marrë në dorëzim kishën shqiptare të Fan Nolit, të At Kristo Negovanit dhe të Stathi Melanit, në këtë qendër të madhe që po të lihet e mbyllur edhe për një muaj dhe pastaj e mbyllin të tjerët definitivisht”.


Një dimension tjetër atdhetar i kësaj teqeje mund të vërehet edhe në korrespondencat apo dorëshkrimet e vizitorëve të huaj në Detroit, të cilët gjenin aty në të vërtetë një oaz shpirtëror sipas modeleve më të mira të teqeve shqiptare. Konfiguracioni i teqesë, oborrit e kopshtit në shumë raste plotësohej me figurat e klerikëve, të cilët sipas këndvështrimit të doktrinës së këtij tarikati falnin kurdoherë vllazëri, madje çdo mendim dhe fjalë e tyre do të shkonte në detin e mëshirës universale myslimane. Jo rrallë të huajt që vinin në atë teqe i entuziazmonte jo shumë mistika fetare sesa shqiptarizmi dhe vlerat e tij morale të panjohura për ta. “Vizualisht dhe filozofikisht, - do të shprehej, - Zane Irvin Broun, teqeja bektashiane është në kontrast dhe qartazi larguar nga ndërtimet urbane rreth saj. Në verë gjithçka gjallon këtu”. Por nga ç’kuptim mund



Baba Rexhepi u përpoq gjithmonë për të siguruar sfondin e duhur intelektual dhe shpirtëror në vitet e para e të vështira të çeljes së teqesë. Tirana zyrtare e asaj kohe e kishte renditur këtë klerik në listën e gjatë të "armiqve të partisë dhe të popullit". Kjo nuk e ndali atë. Në Amerikë ai ruajti kontakte edhe me një figurë tjetër fetare, Fan Nolin, për të cilin kishte një respekt të veçantë. Këta dy klerikë u ritakuan pas më shumë se tri dekada, në Boston, në ceremoninë përkujtimore të vdekjes së Faik Konicës, në vitin 1952. Në bisedën që patën mes tyre baba Rexhepi kujton se si Imzot Noli çmonte dhe nderonte teqetë dhe klerikët bektashianë, rolin dhe veprimtarinë e tyre patriotike që në vitet e Rilindjes Kombëtare, si dhe veprimtarinë e tyre të palodhur në shërbim të forcimit e vllazërimit midis shqiptarëve. Imzot Noli i kishte shprehur dëshirën e madhe që së shpejti edhe në Amerikë të kishte një teqe bektashiane. Dëshira u bë realitet duke përmbushur ëndrrat e shumë shqiptarëve. Vetë Noli e vizitoi atë madje dha edhe një kontribut financiar prej 500 dollarësh.

të përcillen këto vlera të një besimi krejt të panjohur për amerikanët? Cilat mund të jenë ato dëshmi që ndonëse flenë në pergamena të shekujve të shkuar, të ringjallen prej klerikësh bektashinj? Një përgjigje interesante e kam marrë prej studimit të Frances Trix, e cila ka hulumtuar për vite të tëra bektashizmin me baba Rexhepin. Dëshmia e saj për kohën e qëndrimit pranë teqesë në Detroit dhe mësimet që mori prej tij janë një shembull sesi besimi bektashian është një frymëzim dhe shprehës i vlerave më të mira të tolerancës dhe mirëkuptimit fetar, respektues i dinjitetit njerëzor dhe kombëtar.

Edhe pas largimit nga kjo botë e baba Rexhepit, misioni i teqesë bektashiane në Detroit nuk u ndal. Veprën e tij e vijoi më tej baba Arshi Bazaj, i cili gjatë dyzet viteve të qëndrimit me myrshidin e tij ishte gurë i rëndë themeli në këtë shtëpi të Zotit. Ai e vijoi traditën e mësuesit shpirtëror duke u mbajtur fort pas parimeve atdhetare dhe fetare, sepse vetëm një ndërthurje natyrore e këtyre nocioneve, do të thotë jetëgjatësi. Dëshira ime është t'i mbyll këta rreshta për teqenë e baba Rexhepit me përshëndetjen që



ish presidenti i SHBA, Barack Obama i dërgoi teqesëme rastin e 60 vjetorit të çeljes së saj. "Kam kënaqësinë që të bashkohem me kremtimin e 60 vjetorit tuaj. Gjatë gjithë historisë së kombit tonë, vendet e adhurimit na kanë bashkuar me frymën e dashurisë dhe besimit. Ofrimi i hapësirës për kremtim në kohë gëzimi dhe ngushëlliminë kohë të pasigurta, ndihmojnë dhe nxitin ndjenjën e fortë të komunitetit, duke na ftuar për të përmbushur përgjegjësitë më të skajshme, për të vënë veten në shërbim të të tjetërve. Ashtu siç e keni të shënuar këtë moment historik të veçantë, unë shpresoj që ju të krenoheni me përkushtimin e komunitetit tuaj të besimit"

Gjurmë bektashiane në Bullgari, kjo ishte përafërsisht ideja e Prof. Stefan Naumov-Bullgari, i cili u ndal në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e teqesë së Demir Babait. Ai hodhi dritë mbi dëshmitë e atyre shekujve kur perandoria otomane në Ballkan, shfaqej e vendosur për territore fizikë dhe shpirtërore dhe kur tarikati bektashian, shpesh ka shërbyer si urë bashkëpunimi midis myslimanëve dhe krishterëve, duke mundësuar në mjaft raste edhe një harmoni e bashkëjetesë fetare midis tyre.

Ndërsa Dr. Atakan Dereliogly, Turqi, duke folur për moralin e vyer të Haxhi Bektash Veliut, të transmetuar në besimtarët bektashi tha midis të tjerave: "Çdo shkollë që synon edukimin njerëzor ka një qasje të caktuar arsimore me objektiva për të arritur. Këto qasje kanë marrë formë rreth

personave që zakonisht janë personalitete shpirtërore, të njohur dhe historikë që i kanë dhënë emrin shkollës. Kur flitet për bektashizmin pa dyshim se ky person është Haxhi Bektash Veliu, i cili i ka dhënë emrin e tij në rendin e tarikatit bektashi. Ai udhëhoqi dhe formalizoi Bektashizmin nëpërmjet veprave të tij dhe pasardhësve që i edukoi.

Midis veprave të Haxhi Bektash Veliut, Makalat me një natyrë mistike është vepra më e plotë dhe e rëndësishme. Në këtë vepër, ai e fillon me fjalimin e tij hyrës duke thënë: "Kjo vepër deklaron se sa faza do të kalojë njeriu për të arritur Qenien Hyjnore, Allahun" (Haxhi Bektash Veliu, Makalat, fq.27). Haxhi Bektash Veliu përshkruan mësimdhënien katër dyer - dyzet vende si metodë për të arritur Qenien Hyjnore, Zotin. Ajo që nënkuptohet me katër dyert janë: 1. Sheriati ose rregullat thelbësore të fesë, 2. Tarikati ose rruga e mistikëve, 3. Marifeti ose dija hyjnore irfan, si dhe e katërta hakikati e vërteta ose manifestimi i së vërtetës hyjnore. Dyzet vende janë dyzet hapa që hidhen përmes hyrjes në këto dyer. Katër dyert dhe dyzet vende kanë për qëllim të jenë një metodë e transformimit dhe procesit të vetëvlerësimit nëpërmjet të cilit shpirti i papërsosur e i mangët, arrin një shpirt të përsosur njerëzor me përvojat e veta personale (Kurshunoglu, 2014). Ky proces i transformimit kryhet nën drejtimin e një mentori (dijetari fetar, murshidi).

Katër dyert dhe dyzet vende kujtojnë nevojat e hierarkisë së Abraham Maslou. Nevojat njerëzore, sipas Maslou, variojnë nga kërkesat themelore fiziologjike dhe siguria, nga dashuria dhe nderimi, dhe nga 'vetë-aktualizimi'. Ndërsa kalon nëpër çdo fazë specifike brenda mësimin të Haxhi Bektash Veliut në katër dyer dhe dyzet vende, personaliteti ose realizimi i vetvetes është i ngjashëm me hierarkinë e nevojave të Maslout (Karaxhosh, 2007, fq. 93).

Haxhi Bektash Veliu i kategorizon njerëzit nga pikëpamja e arsimit në "er kişi" (i formuar ose shenjtor) dhe "ham kişi" (person i paformuar, shpirtra të paformuar). Një person i formuar ose një shenjtor është një person i mirë trajnuar. Me një kuptim, fjala "Erenler" (individë të pjekur, shenjtorë) rrjedh nga ky koncept dhe ky kuptim. Pra, "Erenler" janë njerëz që kanë përfunduar trajnimin e tyre; kanë arritur përsosmërinë. Shpirtrat e paformuar ndahen në dy kategori. Ata që janë të prirur për t'u trajnuar (ata që nuk kanë humbur aftësinë e tyre të maturimit) dhe ata të cilët nuk janë në gjendje të marrin trajnim (ata që kanë humbur aftësinë e tyre të maturimit). Ata që janë të prirur për t'u trajnuar janë ata që "janë zgjuar nga gjumi i pavullnetshmërisë".

Kur shohim librat e dorës së parë, të cilat përcaktojnë shtyllat kryesore të rendit bektashianë, shihet se modeli i brendshëm i edukimit është adoptuar në mënyrë që t'u mundësojë njerëzve që të fitojnë moral të mirë. Në bektashizëm, para së gjithash, personi futet tek vetja e tij trupore duke qenë i informuar për tendencat e tij ndaj së keqes dhe së mirës. Kjo qasje e ka bazën e saj teologjike nga një fjalë ndër fjalët e shprehura me mençuri nga Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi Të): "Kushdo që e njeh veten, e njeh Zotin e tij." Në veprën e tij Makalat, Haxhi Bektash Veliu jep shembullin e "një shisheje plot me fëlliçësi". Kjo shishe e mbushur me fëlliçësi dhe ndyrësi dhe me tapë të mbyllur, sikur të lahej në një oqean për vite të tëra nuk do ta pastrohej dot. Ajo që është e domosdoshme është hapja e kapakut të shishes, heqja e papastërtisë brenda saj dhe më pas pastrimi i saj (Haxhi Bektash Veliu, Makalat, fq. 51). Deklarata e Haxhi Bektash Veliut duket se jep një mesazh të tillë: nëse një person nuk e zhvillon edukim moral nga brenda, ai nuk do të jetë një njeri i pastër dhe moralisht i mirë (insan al-kamil, një qenie njerëzore e përsosur dhe e pjekur).

Në veprat e tij, Haxhi Bektash Veliu trajton prirjet njerëzore ndaj së mirës dhe së keqes në kuptim të rezultateve të tyre emocionale dhe të sjelljes. Kjo qasje është shumë e rëndësishme për edukimin moral. Sepse, njerëzit që nuk kanë vetëdije emocionale dhe mendore, nuk mund të japin llogari për pasojat e mundshme të ndonjë emocioni apo sjelljeje që ata e pranojnë. Ata nuk mund të parashikojnë rezultatin përfundimtar të një emocioni që ata nuk mund ta kontrollojnë. Haxhi Bektash Veliu tërheq vëmendjen ndaj marrëdhënies shkak-pasojë midis emocioneve dhe sjelljeve. Ai ka bërë disa pika relevante për këtë çështje në veprën e tij "Makalat". Ai flet për dymbëdhjetë marrëdhënie shkakësore midis emocioneve dhe sjelljeve. Ai thotë se: "Kushdo që dëshiron moral dhe sjellje të mirë e do frikën (respekt dhe ndrojtje nga Zoti); kushdo që dëshiron frikën ndaj Zotit, shmang bërjen e gjynaheve (maturi; perzhiz); kushdo që dëshiron të shmangë gjynahet duhet të jetë i duruar; kushdo që dëshiron durim, e do ndruajtjen dhe modestinë; kushdo që dëshiron ndruajtjen dhe modestinë,





do dashurinë dhe bujarinë; kushdo që dëshiron dashurinë dhe bujarinë, e do nevojnë (miskin); kushdo që dëshiron nevojnë, e do diturinë (ilm); kushdo që dëshiron dijen, e do njohjen e Zotit (marifet); kushdo që dëshiron njohuri për Zotin, e do shpirtin e vet ose veten e vërtetë (jan); kushdo që dëshiron shpirtin e vet, e do arsyetimin (akl); kushdo që dëshiron të arsyetojë, e do Allahun e Lartësuar (Haxhi Bektash Veliu, Makalat, fq.28, 29).

Haxhi Bektash Veliu shpjegon se si ndjenja e moralit dhe sjelljeve të mira (adab) mund t'i afrojë njerëzit më pranë Allahut të Lartësuar hap pas hapi. Njerëzit mund të mos jenë në gjendje të krijojnë një marrëdhënie dialektike ose marrëdhënie shkak-pasojë midis ndrojtjes (modestisë) dhe bujarisë, bujarisë dhe njohurisë. Për shembull, ata mund të mos e dinë se ndjenja e durimit mund të përmirësohet nga maturia. Është kjo lloj njohurie që e bën Haxhi Bektash Velin një edukator të madh shpirtëror dhe moral. Ai tregon vendin e emocioneve dhe ndjenjave në procesin e arritjes së Zotit. Kështu, ai e hap udhën drejt Zotit në udhëtimin shpirtëror të dervishëve.”

Në fund të këtij paneli, Dr. Entela Muça foli për frymën nacionale që ka shoqëruar bektashizmin në krejt zhvillimet

e tij, sidomos në Shqipëri. Në fund ajo tha: “Tarikati bektashi në vetvete do të thotë shpresë dhe jetë, dashuri dhe paqe. Bektashizmi si një sistem i caktuar teologjik me zanafillën e tij në Anadollin e largët si të gjitha besimet u përhap në një nga zonat më nevralgjike të Ballkanit perëndimor Shqipëri dhe gjeti përkrahje në një pjesë të mirë të popullsisë. Një nga format klasike të propagandimit në popull të ideve qëllimit të përhapjes së këtij besimi arsyet e shfaqjes në hapësirën vakum të besimeve fetare në përgjithësi në territoret Shqiptare ishte me anë të lëvizjeve të popullsisë. Në fillim nëpërmjet emisarëve të tij, dervishëve shëtitës.

Tarikati bektashian është parë si diçka përparimtare që guxon të thyejë rregullat e vendosura prej kohësh kanë një diapazon të gjerë të besimit që propagandon fenë dhe lidh fenë me kombin është baza e çdo gjëje. Identiteti kombëtar do të thotë pavarësi liri të të drejtave të njeriut që i përket një race, një kombi të caktuar. Lidh ngushtë idealen, logjikën me materien realitetin. 2. Prej kësaj buron bektashizmi dhe bektashinjtë në përgjithësi janë të prirë dhe përkrahin çdo lëvizje përparimtare që të çon drejt progresit, propagandon çdo lëvizje që sjell përparim dhe këtë e bëjnë të gjithë klerikët dhe besimtarët e këtij

tarikati. Këtëj vjen dhe përshtatja apo përqafimi i saj nga njerëzit dhe respekti që ka populli që i përkasin besimeve të tjera dhe vetë autoritetet e këtyre besimeve ndaj besimit bektashian. Është besim që në thelbin e tij ka besimin në një Zot që drejton Universin, ndërsa ne jemi zbatuesit e urdhrave të Tij.

Me këto mësimet dhe ide të përvetësuara përhapësit e besimit që erdhën nga Anadulli e u vendosën në Shqipëri krijuan me kohë atë që një pjesë e popullsisë që i përqafoi idetë dhe qëllimin e besimit, panë se ajo mund tu zgjidhte dhe orientonte drejt për problemet e tyre. Në Shqipëri, u krijua një brez bektashinjsh që për rrethanave të ndryshme u vendosën në jug të vendit dhe të rritur me virtyte pozitive të gatshëm ti shërbenin vendit, kombit madje, të jepnin dhe jetën e tyre krijuan një traditë të shkëlqyer që do të transmetohej brez pas brezi. Përmendim Ali Pashë Tepelenën. 3., idetë e tij për të ruajtur pavarësinë e vendit nga Porta e Lartë. Rëndësia dhe vlerësimi i veprimtarisë dhe ndikimi i besimit Bektashi tek Ali Pashë Tepelena vihet re qartë në një nga shkrimet. Fan S. Noli kur thotë “Tamam 400 vjet pastaj si Gjon Kastriotisi Ali Pashë Tepelena porosiste robinët çifutë, hoxhët muhamedanë, baballarët bektashinj dhe priftërinjtë ortodoksë, ti luten Perëndisë për shpëtimin e tij në haired he në xhamira, në teqe dhe në kisha dhe ta zgjojnë të lartin që e harroi Shqipërinë”. Ali Pashë Tepelena me zgjuarsinë dhe forcën që e karakterizonte diti të shfrytëzonte momentet historike në shërbim të atdheut, shoqërisë Shqiptare në veçanti, por duke i dhënë një kontribut jot ë vogël për shoqërinë myslimane të ndodhur në territoret e Shtetit Osman dhe komunitetit bektashian, zhvilloi një propagandë pro bektashiane. Ashtu siç e ka theksuar dhe Nuraj Bazbora Ali Pashë Tepelena synoi rritjen e ndikimit të besimit bektashi tek myslimanët e jugut. Në “Fletore Bektashiane” shkruan se fjala e urtë ishte koncentrat i gjithë përpjekjeve të shumë figurave të shquara për të lidhur shqiptarët me tarikatit bektashian me atdheun dhe zhvillimet moderne bashkëkohore për këtë

është dashur kontributi i figurave të tilla si Skënderbeu, Ali Pashë Tepelena, Ibrahim Temo etj.

Kjo traditë vazhdoi dhe u forcua më tej në shekujt pasues me Rilindasit tanë përfaqësues të denjë të bektashinjve shqiptarë mendimtarë, ideologë, filozof, politolog, poetë, shkrimtarë, patriotë si vëllezërit Frashëri, Abdyl., Naim., dhe më të voglin prej tyre Sami Frashërin ose i njohur ndryshe si Shemsedin Sami bej Frashëri, i cili mbronte tezën se “substancia e gjithësisë është eteria”. Përmendim anëtarët e shoqërisë Bashkim e Përparim, kryetarin e saj, Ibrahim Et'hem Temo (Sojli) dhe Nuri Sojli. Ata luftuan me forcë dhe vetëmohim për një shoqëri të lirë demokratike në përgjithësi dhe atë shqiptare në veçanti. Besimi i klerikëve bektashi në këta luftëtarë i ishte aq i madh sa ata i besuan dhe pasuritë e teqeve për zbatimin e testamenteve të tyre. Përmendim rastin e Baba Kamber Sadikut të teqes së Derbendit i cili “shënoi zëvendës fuqiptotë, Dr. Ibrahim Temon. Po në Shqipëri cilat ishin veçoritë e përhapjes së këtij tarikati? Si erdhi dhe u përhap ky besim në trojet shqiptare dhe në popullin tonë? Si dhe pse shqiptarët e përqafuan këtë besim? Në ç'pjesë të territorit të vendit hyri besimi bektashi? Në cilën pjesë të popullatës u përqafua më lehtësisht dhe pse? Kontributi i tij në besimin bektashian qëndron në evidentimit të raportit mes koncepteve fe-komb përcaktimit e rolit dhe vendit të të dy koncepteve. Më poshtë po japim disa prej mendimeve të tij të vlerësuara nga shumë politikanë e dijetarë të kohës. Ibrahim Temo mendonte se të gjithë njerëzit qofshin të besimit kristian (ortodoks dhe katolik) apo të besimit Islam (syni dhe bektashi) janë të një mendimi, të gjithë njerëzit të kujtdo besimi race apo kombësie qofshin të gjithë ata duhet të luftojnë të bashkuar për një qëllim të vetëm atë të ruajtjes të paprekur të identitetit kombëtar dhe kombit. Mendimi i intelektualëve të patriot përparimtarë shqiptarë të kohës ishte një: bashkëjetesa e të gjitha feve ishte e mundur duke flakur fanatizmin.” Sot konstatojmë me kënaqësi të veçantë që Selia Botërore Bektashiane

me qendër në Tiranë, e udhëhequr prej Dede Edmond Brahimaj, po bën çdo përpjekje të mundshme jo vetëm për konsolidimin e tarikatit, por edhe për një përqafim sa më dinjitoz të tij në rrafsh ndërkombëtar. Edhe vetë risia e organizimit të simpoziumeve të tillë në prag të festës së Sulltan Novruzit, është refleksion i këtij perceptimi të Selisë së Shenjtë. Gjatë zhvillimit të këtij paneli, pati pyetje dhe diskutime të ndryshme si nga Kryegjyshi Botëror Bektashian, ashtu edhe studiues të tjerë, të interesuar për situatat e djeshme dhe të sotme, duke hedhur dritë mbi ngjarje të ndryshme dhe duke e bërë sa më frutdhënës eventin.

Koresp. Urtësia

PREHJE HYJNORE

Meditim në tetë vjetorin e largimit nga kjo botë të myrshidit tonë, dede Reshat Bardhi

Tashmë katër prilli ka fituar vendin e vet, në ditët e shenjta të kalendarit bektashian. E kanë në sy të gjithë, klerikë e besimtarë nga teqja e ringritur e Gjakovës deri tek ajo e Lazaratit, nga Kuzum-Babai i Vlorës, deri në Harabati-baba të Tetovës. Madje edhe më larg akoma, nga teqja e Detroidit na vjen lajmi se mblidhen disa myhibanë të vjetër dhe kuvendojnë për shpirtin e shenjtë të dede Reshatit. Disa shkrepitima të çuditshme malli, mbajnë gjallë figurën emblematike të këtij burri, me jetët tona. Edhe ata që e patën takuar pak herë edhe ata që ja dëgjuan zërin pak herë, edhe ata që e kundruan në sytë e tij të gjelbër pak herë, ndjejnë se kanë ecur së bashku me myrshidin tonë në dhjetëra vite drite, në raste gëzimesh të befta e dhimbjesh të përjetshme. Prania e tij fizike dhe shpirtërore janë shkrirë e bërë njësh në detin tonë të kujtimeve që nuk flenë.


Dervish Abdylmutalib Beqiri më rrëfen për një mbrëmje të largët të nëntorit të vitit 2004m, kur dedei ynë kishte shkuar në teqenë Harabati-baba të Tetovës. Kishin arrë vesh se do të vinte dede Reshati dhe erdhën nga Gostivari e Zdunja,

nga Tetova e nga Kërçova, nga Kumanova e Kanatllara. Zjarri bubullinte në vatër dhe dedei po rrëfente një ngjarje që lidhej me Imam Aliun, paqja qoftë mbi 'Të. Kur mbaroi, dikush nga ne e pyeti: "Hejvallah, kam dëgjuar se keni vuajtur boll në Mallakastër me dede Ahmetin.". Dedei u mendua dhe me pak fjalë na tha diçka që na ngazëlleu të gjithëve. Pak a shumë, fjalët e tij, ishin këto: "Unë me myrshidin tim, vërtetë vuajtëm ca kohë, por në fund të fundit ishim në teqe, kishim shtrojë e mbulojë, kishim besimtarë që na donin e vinin fshehurazi na takonin. Por të tjerë si baba Ali Tomorri, baba Shefqet Koshtani, baba Bajrami, baba Kamberi, u torturuan burgjeve të egra." Sytë dhe veshët i kishim tek dedei ynë. Ka një hadith kuranor që thotë se në bisedat me të

Dërguarin e Allahut ne "rrinin sikur të kishim mbi supë një zog dhe druoheshim se po të lëviznim, ai do të trembej dhe do të fluturonte".

Për biseda të tilla, ku vëllazëria bektashiane prehej në dimensione të reja paqeje, kam dëgjuar të flitet kudo ku shkeli këmba e dede Reshatit.


Madje, në vitet e vështirë të ndalimit të fesë, vendi i punës i tij, ai kopësht i lulëzuar në periferi të Tiranës, larg syve të ligj, u



shndërrua dalë nga dalë në një prehtore jo vetëm për bektashinjtë, por krejt ata që besonin në Zot. Ardhur nga çdo vis i Shqipërisë, besimtarëve në mënyra nga më të ndryshmet dhe të fshehtat, dëgjonin fjalët e dede Reshatit që dukej se nuk dilnin prej buzëve të tij, por prej burimeve të kulluara të Ehli-Bejtit. Pikërisht në këtë kontekst, llogaritë ideologjike malinje të kohës, ishin bërë gabim. “Ai flet me engjëjt në qiell”, ka qenë shprehja e dëgjuar shpesh nga besimtarët dhe kjo profeci fitonte çdo ditë e më tepër dimensione të një adhurimi jetësor.

Përgjatë peizazheve gri të zvetënimit shpirtëror, ky përfundim tingëllon si diçka paradoksale, por realiteti shqiptar nuk mund të jetonte në zbrazëti, pa atë marrëdhënie organike me pjesën tjetër që vetë zoti e dëshironte. Në çdo anë ta kundrosh, komunikimi dypalësh i dervish Reshatit (me besimtarët në tokë dhe Zotin në qiell), tek e mbramja, mund të merret si një realitet i afërm në kufijtë

Dede Reshat Bardhi do të mbetet përjetësisht i gjallë në memorien tonë, në udhën që kemi nisur, në sakrificat dhe gëzimet tona, sepse çdo çast i jetës së tij në këtë botë dhe tjetrën, është jetuar me dashurinë për Zotin dhe njeriun. Gati shtatë dekada më parë, myrshidi ynë, erdhi në Selinë e Shenjtë të Kryegjyshitës si një fat i madh, si një ogur i bardhë dhe deri në çastin e mbramë ne na përcolli fryma e tij e shenjtë. Ne që e njohëm, padyshim që ishim me fat, por edhe miliona të tjerë, anë e kënd botës që nuk e patën takuar, që nuk ja kishin dëgjuar zërin, kanë jetuar dhe jetojnë brenda vëllazërisë bektashiane që ai shpërndante. Në jetën dhe veprën e dede Reshat Bardhit, lidhet periudha më e vështirë e udhës së Hakut, ajo e persekutimit fetar. Në ato vite të vështirë, dedei ynë së bashku me dashurinë për Zotin, rrëfen dashurinë e pafund edhe për myrshidin e tij, dede Ahmetin, të cilit nuk iu nda deri në 10 korrikun e vitit 1980, për t’iu bashkuar sërish tetë vite më parë. Kjo dashuri emblematike midis myrshidit dhe myridit, përbën padyshim një ngjarje jo thjeshtë për dy klerikë, por i jep shkëlqimin e vet krejt historisë 800 vjeçare të besimit bektashian. Gjithçka e realizuar pas viteve 90-të të shekullit që lamë pas, në kuptimin e ringritjes dhe objekteve të kultit bektashian, mbanë vulën e përpjekjeve dhe sakrificave të tij. Dede Reshati ka gjithashtu meritën e padiskutueshme që ringriti besimin e klerikëve bektashinj. Ai na mësoi ne, jo vetëm urtësinë dhe sekretet e tarikatit, por edhe mënyrën se si të afrohem në devotshmërinë ndaj krijuesit, si të duam dhe drejtojmë familjen tonë të mrekullueshme.



transhendentë të besimit. Në ceremoninë e mevludit në këtë rast nuk kanë munguar as vëllezërit tanë të komunitetit Mysliman të Shqipërisë, për të cilët fjala e dede Reshatit ka pasur kurdoherë peshën e saj të çmuar. Ndërkaq, këndimit të haditheve kuranorë i janë shtuar përveç klerikëve bektashinj, edhe myhibë të ardhur nga gjithë viset shqiptare. Hadithet e dalë shpirti, të ngajnë se rezonojnë jo thjeshtë me muret e mejdanit, por me krejt gurët e drurët e këtij vendi, të cilët Ai vetë i vendosi, vetë i mbolli, vetë i veseliti.

Ndërsa në drekën e shtruar, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, shtoi midis të tjerave: "U mbushën plot tetë vite nga dita e largimit të Tij nga kjo jetë dhe jo vetëm ne këtu, në këtë sallë, por kudo në botë, bektashinjtë nuk mund ta harrojnë njeriun e tyre të zemrës. Dede Reshat Bardhi do të mbetet përjetësisht i gjallë në memorien tonë, në udhën që kemi nisur, në sakrificat dhe gëzimet tona, sepse çdo çast i jetës së tij në këtë botë dhe tjetrën, është jetuar me dashurinë për Zotin dhe njeriun. Gati shtatë dekada më parë, myrshidi ynë, erdhi në Selinë e Shenjtë të Kryegjyshit si një fat i madh, si një ogur i bardhë dhe deri në çastin e mbramë ne na përcolli fryma e tij e shenjtë. Ne që e njohëm, padyshim që ishim me fat, por edhe miliona të tjerë, anë e kënd botës që nuk e patën takuar, që nuk ja kishin dëgjuar zërin, kanë

jetuar dhe jetojnë brenda vëllazërisë bektashiane që ai shpërndante. Në jetën dhe veprën e dede Reshat Bardhit, lidhet periudha më e vështirë e udhës së Hakut, ajo e persekutimit fetar. Në ato vite të vështirë, dedei ynë së bashku me dashurinë për Zotin, rrëfen dashurinë e pafund edhe për myrshidin e tij, dede Ahmetin, të cilit nuk iu nda deri në 10 korrikun e vitit 1980, për t'iu bashkuar sërish tetë vite më parë. Kjo dashuri emblematike midis myrshidit dhe myridit, përbën padyshim një ngjarje jo thjeshtë për dy klerikë, por i jep shkëlqimin e vet krejt historisë 800 vjeçare të besimit bektashian. Gjithçka e realizuar pas viteve 90-të të shekullit që lamë pas, në kuptimin e ringritjes dhe objekteve të kultit bektashian, mbanë vulën e përpjekjeve dhe sakrificave të tij. Dede Reshati ka gjithashtu meritën e padiskutueshme që ringriti besimin e klerikëve bektashinj. Ai na mësoi ne, jo vetëm urtësinë dhe sekretet e tarikatit, por edhe mënyrën se si të afrohem në devotshmërinë ndaj krijuesit, si të duam dhe drejtojmë familjen tonë të mrekullueshme. Gjej rastin të falënderoj sot organizatorët e kësaj përkujtimore, dhe veçanërisht zotin Jetmir Bodini, për kontributin e vazhdueshëm për zhvillimin e bektashizmit."

Zemrat e paqta tonat, përcjellin me rrahjet e tyre, prehjen hyjnore të dede Reshat Bardhit.

Syrja Xhelaj



TË PIJMË NGA BURIMET E DLIRA TË EHLI-BEJTIT

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij,
Haxhi Dede Edmond Brahimaj, kryen vizita të suksesshme në Qerbela dhe
Bagdat



Martirizimi i Imam Hysenit, paqja qoftë mbi 'të, është shndërruar tanimë jo thjesht në një akt evokimi historik, por në një pelegrinazh që mbledh në gjirin e tij besimtarë myslimanë të etnive, racave dhe kombeve të ndryshëm. Të grumbulluar në Qerbela,

(miliona prej tyre ecin dhjetëra kilometra në këmbë familjarisht) ata i drejtohen tyrbes së shenjtë të Imamit tonë me ndjenjat më të spikatura të dashurisë, duke përcjellë së bashku me dëshminë e dlirësisë hyjnore të Tij, idenë e madhe që familja e Profetit Muhamed, paqja qoftë mbi 'të, Ehli-Bejti i pastër, ishte

dhe mbeti i tillë në devocionin e saj ndaj Krijuesit. Tragjedia e Qerbelasë, ashtu sikundër e kanë përcaktuar personalitete të shquar nga e gjithë bota, të djeshëm dhe të sotëm, është shembulli më i shkëlqyer se si jeta në këtë botë, këmbëhet pa dhimbjen më të vogël, për të shkuar në tjetrën si një shërbestar përlulur me margaritarët e dliresisë në shpirtin e pafajshëm.

Me ftesë të organizatorëve të këtij eventi kaq madhështor për krejt botën myslimane dhe posaçërisht të Imamit të Mesxhidit të Shenjtë të Abaz Aliut a.s, Sejjid Ahmet Essafi në datat 10-12 prill 2019, Kryegjyshi Botëror Bektashian kreu në Qerbela dhe Bagdat disa vizitat të suksesshme tek vëllazëria jonë e Ehli-Bejtit. Në këto vizita, tek ato vende që kanë mbetur po aq të shenjta sa dhjetëra shekuj më parë, delegacioni bektashian, përveç bisedave të ngrohta për zhvillimet apo sfidat e ndërsjellta, kreu ritet fetare të duhura, si edhe mori urimet dhe bekimet e njerëzve me të cilët u takua. Nuk do të mungonin gjatë këtyre ditëve edhe lutjet e përbashkëta me lider fetarë irakenë, për një paqe sa më të qëndrueshme në Lindjen e Mesme por edhe në botë.

Imami i Mesxhidit të Shenjtë të Abas Aliut a.s ishte i pari që priti delegacionin bektashian dhe pas falënderimeve për pjesëmarrjen në këtë event, u interesua të dinte sa më shumë rreth zhvillimeve fetare në Ballkan dhe ën veçanti për sfidat që dalin përpara Selisë së Shenjtë Bektashiane, në kuptimin e sendërtimit të mësimave të vyera të Ehli-Bejtit në radhët e besimtarëve. Njëherazi ai donte të informohej për rolin e madh të bektashizmit të sotëm për të zvogëluar keqkuptimet në gjirin e myslimanëve si edhe për të zhdukur imazhet e rreme që përpiqen të bëjnë histori fetare.

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, së pari e njohu të zotin e shtëpisë për rrugët përmes të cilave ka kaluar tarikati bektashian, për të ardhur deri në këtë milenium. I frymëzuar nga urtësia dhe mençuria e Haxhi Bektash Veliut, ky tarikat ka kaluar sprovat më të mëdha, duke u identifikuar me vlerat e Islamit dhe duke fituar frymëmarrje jo vetëm veprës së Profetit Muhamet, paqja qoftë mbi 'Të, por edhe prej porosive të Kuranit të Lartë si edhe dymbëdhjetë imamëve të pastër. Ndërsa në lidhje me përgjegjësitë e sotme historike të Selisë së Shenjtë Bektashiane, Kryegjyshi Botëror tha midis të tjerave: "Qysh prej ardhjes në Shqipëri

të Qendrës Botërore Bektashiane, liderët e saj janë përpjekur të mbajnë të pa cënuara lidhjet me komunitetet bektashiane të kudondodhur në botë, të bindur se këto lidhje do të mbajnë gjallë besimin dhe do të mund të përballojnë sfidat si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim. Për këtë Qendër Botërore, sigurisht ka qenë një periudhë shumë e vështirë, në vitet 1967-1990, ku u ndalua me kushtetutë zyrtarisht ushtrimi i besimit fetar dhe ku dhjetëra klerikë u ndoqën, persekutuan dhe burgosën nga regjimi ateist. Por edhe në momente kaq të vështirë, shpirti i besimit bektashian nuk reshti së rrahuri për Zotin e Lartë. Në ilegalitet të plotë, klerikët dhe besimtarët bektashianë, sikundër edhe besimtarët e feve të tjera në Shqipëri, i përkujtuan ditët emblematike të historisë së tyre, kremtuan festat dhe vijuan praktikat shpirtërore, duke sfiduar kësisoj ateizmin e pashembullt. Ndërsa pas viteve 90-të, të shekullit të kaluar dhe deri sot, Selia e Shenjtë Bektashiane ka marrë përsipër jo vetëm ringjalljen e besimit përmes ringritjes së objekteve të kultit në Shqipëri, por edhe përkujdesjen e saj e saj të dukshme në lidhje me komunitetet bektashi në botë. Përveç veprimtarive të përvitshme ndërkombëtare, ne po formulojmë dalë ngadalë koncepte e perceptime për brezat e besimtarëve të sotëm, që këta të jetojnë sa më pranë Islamit në këtë botë moderne të sulmuar aq fort nga sekularizmi dhe materializmi ekstrem."


Të nesërmen e këtij takimi, në Konferencën Ndërkombëtare me pjesëmarrjen e liderëve fetarë nga bota arabe, fjala e Kryegjyshit Botëror Bektashian, u prit me shumë interes. Midis të tjerave, Haxhi Dede Edmond Brahimaj u shpreh: "...Është kënaqësi e veçantë për mua por njëherazi edhe privilegj i rrallë, të marr pjesë në konferencën e sotme, ndaj do të më lejoni t'ju sjellë të gjithëve, urimet dhe bekimet më të sinqerta të miliona besimtarëve bektashinj në të gjithë botën, të cilët unë i udhëheq prej tetë vitesh. Jam gjithashtu me fat, t'ju kujtoj të gjithëve ju sot, se të gjithë bektashinj, nga Azia e largët, në Ballkan, Europë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada dhe deri në Australi, prej 800 vitesh, sytë, mendjen dhe zemrat e tyre i kanë këtu, në Qerbela në këtë vend të shenjtëruar me gjakun e Imam Hysenit, paqja qoftë mbi Të dhe të Abaz Aliut, paqja qoftë mbi Të, duke ju kujtuar të gjithëve se vlerat e diturisë hyjnore dhe qëndresës burrërore, i kapërcejnë shekujt. Fakti që tragjedia e Qerbelasë, kujtohet ende me pikël-

Haxhi Dede Edmond Brahimaj:

Ndërkaq, ne bektashinjtë mendojmë se gjaku i të parëve tanë, i derdhur rrëke në këtë vend, nuk mundet të vadisë urrejtjen dhe mërinë e verbër, përkundrazi, akti sublim i imamëve tanë dhe 72 dëshmorëve të tjerë, na japin kurajën dhe gravitetin për të qëndruar të papërkulur në devotshmërinë ndaj Allahut, si dhe për të ngritur ura të qëndrueshme harmonie dhe bashkëjetese me vëllezërit në krah, pavarësisht ngjyrës, racës, etnisë apo teologjisë fetare që i përkasin. Ne besojmë në një Zot të vetëm dhe s'mund të jemi tjetër veç vëllezër e motra. Tarikati bektashian, qysh në sendërtimin e tij prej Haxhi Bektash Veliut dhe deri më sot, ka manifestuar në çdo kohë dhe vend të ekzistencës, frymën e paqtë, mëshirën emblematike myslimane, ndjenjat më të kulluara të vëllazërisë. Në mejdanet dhe teqetë tona, vëllazëria e Hakut njihsohet në çdo rast me vëllazërinë, biologjike, duke e shndërruar besimin në Zot si rrallëkush tjetër, në paqe të përjetshme. Dhe jam i lumtur t'u them vëllezër të mijë, se bektashinjtë sot, numërojnë dhjetëra milionë ndjekës në 31 vende të botës. Nga kjo foltore e sotme, jam gjithashtu krenar t'u kujtoj se bektashinjtë, së bashku me Kuranin Qerim, fjalët dhe veprat e Shkëlqesisë sonë Muhamedit, i kanë shndërruar në udhëheqje për veprim mendimet e dymbëdhjetë imamëve, jo thjeshtë si një evokim ndaj të kaluarës, por edhe si përgjegjësi e sotme, për të qenë kurdoherë në paqe dhe bashkuar përballë sfidave që na sjellin fati dhe kohërat që kalojmë".



limin e thellë për dëshmorët e përjetshëm, por dhe me neverinë e skajshme për Mavijen dhe Jezidin, na rrëfen të gjithëve se çdo flijim për dliresinë hyjnore fal parajsën e përjetme, sikundër përvëlton në zjarr e flakë, ata që devijuan pastërtinë morale të Islamit. Ndërkaq, ne bektashinjtë mendojmë se gjaku i të parëve tanë, i derdhur rrëke në këtë vend, nuk mundet të vadisë urrejtjen dhe mërinë e verbër, përkundrazi, akti sublim i imamëve tanë dhe 72 dëshmorëve të tjerë, na japin kurajën dhe gravitetin për të qëndruar të papërkulur në devotshmërinë ndaj Allahut, si dhe për të ngritur ura të qëndrueshme harmonie



dhe bashkëjetese me vëllezërit në krah, pavarësisht ngjyrës, racës, etnisë apo teologjisë fetare që i përkasin. Ne besojmë në një Zot të vetëm dhe s'mund të jemi tjetër veç vëllezër e motra. Tarikati bektashian, qysh në sendërtimin e tij prej Haxhi Bektash Veliut

dhe deri më sot, ka manifestuar në çdo kohë dhe vend të ekzistencës, frymën e paqtë, mëshirën emblematike myslimane, ndjenjat më të kulluara të vëllazërisë. Në mejdanet dhe teqetë tona, vëllazëria e Hakut njehsohet në çdo rast me vëllazërinë, biologjike, duke e shndërruar besimin në Zot si rrallëkush tjetër, në paqe të përjetshme. Dhe jam i lumtur t'u them vëllazër të mijë, se bektashinjtë sot, numërojnë dhjetëra milionë ndjekës në 31 vende të botës. Nga kjo foltore e sotme, jam gjithashtu krenar t'u kujtoj se bektashinjtë, së bashku me Kuranin Qerim, fjalët dhe veprat e Shkëlqesisë sonë Muhamedit, i kanë shndërruar në udhëheqje për veprim mendimet e dymbëdhjetë imamëve, jo thjeshtë si një evokim ndaj të kaluarës, por edhe si përgjegjësi e sotme, për të qenë kurdoherë në paqe dhe bashkuar përballë sfidave që na sjellin fati dhe kohërat që kalojmë”.

Mjaft mbresëlënëse ishte edhe takimi që delegacioni bektashian bëri me Imamin e mesxhidit të shenjtë të Imam Hysenit, paqja qoftë mbi 'Të, Sejjid Abdylmehdi El-Qerbela, në përkujtimin e dëshmorëve të lirisë dhe drejtësisë të rënë shekuj më parë si dhe në respekt të veprës së pavdekshme të Imam Hysenit. Ai tregoi paskëta për veprimtaritë e shumta fetare dhe kulturore të këtij mesxhidi, me idenë e evokimit të tragjedisë por gjithmonë duke përcjellë mesazhe paqeje. Ndërsa Kryegjyshi Botëror Bektashian, duke hequr një paralele mes ngjarjes së Qarbelasë dhe dhjetëra dervishëve e baballarëve të martirizuar nga armiqtë e fesë, solli shembuj të shumtë që edhe përmes dramave të tilla njerëzore, bektashinjtë i kanë kapërcyer dhimbshëm, duke iu falur mëshirës universale myslimane.

Ndërkaq, takimet, bisedat, lutjet e përbashkëta në vendet e shenjta, kulmuan me pritjen që delegacionit tonë i rezervoi në Bagdat, autoriteti fetar më i lartë, Sejjid Hyssein El-Sadr. Ky personalitet i shquar e përgëzoi Haxhi Dede Edmond Brahimajn për qëndrimet në krye të Selisë së Shenjtë Bektashiane si dhe tendencat rigozorisht moqësore brenda familjes së madhe myslimane. Ai shprehu gjithashtu bindjen e thellë se bektashinjtë, sikundër deri më sot, do ta mbajnë lart dhe të pa përlyer flamurin e Ehli-Bejtit, duke u mbështetur në parimet më të mira të familjes profetike në të mirë të paqes në Ballkan, në Europë e më gjerë. Ai gjithashtu e siguroi delegacionin tonë se Qendra Botërore Bektashiane në Tiranë do të ketë vëmendjen e tij të përhershme, të Konkretizuar

përmes veprimtarish të shumëllojshme.

Kryegjyshi Botëror Bektashian nga ana e tij e falënderoi liderin e lartë për pritjen e ngrohtë, e cila dëshmon veç të tjerave respektin e thellë ndaj vlerave të larta humane të Imamëve të Islamit. Jo çdo tragjedi, vijoi më tej Kryegjyshi, mbetet e tillë në historinë njerëzore. Tragjedia e Qarbelasë është padyshim monumenti i qëndrestarve përballë atyre që kërkonin devijimin e parimeve më të mira të Islamit. Nga dëshmorët e rënë këtu, vlen të marrin mësim liderët fetarë të çdo kohe. Në fund, Haxhi Dede Edmond Brahimaj u shpreh se jemi të vendosur të pimë nga burimet e dlira të Ehli-Bejtit, duke iu afruar në devocionin tonë Zotit të Lartë, duke u vëllazëruar me çdokënd në krah, duke respektuar njeri-tjetrin për një jetë më të paqme në këtë botë për brezat e sotëm dhe të nesërm.

Koresp. "Urtësia"



Humanizmi si themel i paqes

Kryegjyshi Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mori pjesë në takimin plotësues të Dimensionit Human të organizuar nga OSBE në Vjenë, 1-2 prill 2019



Me ftesë të organizatorëve të OSBE, si dhe Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, mori pjesë në takimin plotësues të Dimensionit Human, në Vjenë, më 1-2 prill 2019. Në qendër të këtij event, ishte pikërisht perceptimi dhe rrugët e vendosjes së dimensionit human, në zhvillimet e sotme botërore të para në rrafshin jo vetëm njerëzor, por edhe fetar, në kontekstet respektive. Principet e

tolerancës dhe mosdiskriminimit, si dhe promovimi i lirive dhe ndërgjegjes fetare, diskutimi rreth tematikave që këto ngërthejnë, ishin gjithashtu vlera të shtuara në këtë event, ku përveç liderëve të lartë të Asamblesë Parlamentare të OSBE, merrnin pjesë përfaqësues të lartë shtetërorë dhe fetarë nga e gjithë Europa.

Ishte Ambasador Radomir Bohac, Kryetari i Këshillit të Përhershëm të OSBE, i cili çeli takimet e ditës së parë dhe bëri me dije të pranishmëve për rëndësinë që marrin takime të tilla në kohërat që jetojmë. Ai bëri

gjithashtu edhe një ekspozitë të qartë të vendimmarrjeve të Këshillit të Përhershëm, bazuar në problemet dhe sfidat që hasen shpesh në integrimin e ideve. Paskëtaj, znj. Katarzyna Gardapkhaze, nëndrejtoreshë e Përgjithshme e OSBODIR, në përhëndetjen e saj u ndal në veçanti në rrugët e ndjekura jo thjeshtë për evidentimin e sfidave që dalin, por dhe në idetë dhe projektet realë të ndjekur në përballjen e vështirësive.

Në një prej anekseve të panelit të fundit të ditës së parë, u dha për të pranishmit edhe një konkluzion i shkurtër rreth bashkëzistencës fetare në Shqipëri, i shoqëruar me disa shembuj. Midis të tjerave, në këtë konkluzion, u theksua se bashkësitë fetare në vendin tonë janë të përkushtuara për të edukuar besimtarët e krejt komuniteteve tradicionale që të kuptojnë dhe të interpretojnë mësimet fetare, në mënyrë që të jenë në gjendje që të identifikojnë dhe përgjigjen çdo mesazhi diskriminues. Këto komunitete, në vijimësi kanë ndërmarrë nisma të përbashkëta të shoqëruara me veprimtari të larmishme për të nxjerrur mirëkuptimin e ndërsjellë, për të rritur dialogun ndër-fetar si dhe për të diskutuar në mënyrë më të çiltër të mundshme për dallimet fetare që mund të vijnë nga interpretimet e librave në detyrë. Kjo frymë bashkëpunuese është bërë e mundshme jo vetëm në tryeza të rrumbullakëta, por edhe përmes organizimit të eventeve të ndryshëm fetarë e kulturorë.

Një vlerë e spikatur në këtë kontekst është padyshim përfshirja e të rinjve të feve dhe besimeve të ndryshme për të ndihmuar njerëzit në nevojë, për t'u mundësuar atyre jo vetëm ndihmë por edhe edukim nëpërmjet bamirësive. U theksua gjithashtu se feja në Shqipëri nuk ka qenë askurrë faktor ndarës, përkundrazi, besimtarët shqiptarë kanë identifikuar veten me vlera të tilla

si: atdheu, patriotizmi, dashuria për historinë dhe kulturën kombëtare. Në këtë rrafsh ka luajtur rolin e vet edhe Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë, i inicuar në vitin 2007 dhe përbën sot e kësaj dite një faktor themelor për të siguruar dialogun aktiv e paqësor, duke u bërë barrierë e gjuhës së urrejtjes, apo tendencave të ndryshme ekstremiste.

Në ditën e dytë të takimit, në fjalën e tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, shtoi midis të tjerave: "Principet e tolerancës fetare janë plazmuar qysh në vitet e lindjes së Islamit, nëpër ata shekuj të mugëtirave ku padija ishte shtrirë në shpirtat njerëzorë. Nuk mund të lindë e të zhvillohet një fe apo besim, pa pasur në embrionin e vet, embrionin e bashkëjetesës fetare, atë të komunikimit me zemër ndaj çdokujt, pavarësisht racës, ngjyrës apo etnisë. Këtu nuk është vendi të bëjmë histori, por tanimë historiografia myslimane dhe jo e tillë, ka evidentuar prej kohësh sjelljen e mrekullueshme të Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të) ndaj armiqve të tij, ditën kur hyri çlirimtar në Mekë. Ai mposhti brenda vetes çdo ndjenjë hakmarrëse, duke i ftuar ndjekësit e tij, të konturonin trajtat e mëdha të mëshirës universale islame. Por edhe në vitet që rrodhën më pas, edhe pas sulmeve të ashpër fizikë dhe doktrinorë, ideja e tolerancës fetare ushqeu ndjekësit islamë në krejt vendet ku ata e përfaqësuan këtë fe, ku ata ishin të prirë të edukoheshin me këtë frymë hyjnore. Madje, nëse keni parasysh kontekstet fetarë në shekujt e parë të lindjes së Islamit, mendoj t'ju kujtoj sot shprehjen e mrekullueshme të Profetit tonë, i cili porositi për kundërshtarët se: "Ne do t'ju bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet tona në horizonte dhe brenda vetes së tyre, deri në atë masë sa t'u bëhet e qartë se ai (Kurani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?". (Kurani, Fussilet:53).

Ndonëse fati ynë, i shqiptarëve, ka ecur përmes trazirave ballkanike dhe më gjerë, ne së paku mund të krenohemi me frymën e tolerancës midis feve. Ky akt sigurisht, është vullnet i Zotit, por vlen të mos harrohet për asnjë çast se klerikët dhe objektet e kultit, xhamitë, kishat, teqetë apo të tjera, me atë dhembshuri proverbiale për Atdheun, kanë mundur të edukojnë breza të tërë besimtarësh me devocionin e palëkundur ndaj Krijuesit. Pikërisht ky devocion, na ka mbushur zemrat tona me dashurinë për vëllanë që kemi në krah, madje, në plot raste kemi gjetur frymëzimin e madh brenda familjes fetare, duke i shtuar vlera relevante vetë familjes biologjike. Vetë tarikati bektashi të cilit i përkas, prej tetë shekujt të lindjes dhe zhvillimit të tij, nga Azia në Europë dhe deri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Kanada, i ngjanë një lumi të gjerë e madhështor, i cili në thellësi të ujërave të tij, mbanë perlat e dashurisë ndaj Krijuesit, Atdheut, familjes dhe moralit më të vyer njerëzorë. Të ushqyer me nderimin për thelbin e mirësive që gjenden tek çdo njeri, ne e kemi perceptuar kurdoherë mëkatën si armik të tij, ndërsa mëkatarin si një zog krahë-thyer në stuhi, që kërkon jo thjeshtë mëshirë, por edhe ndihmë për të shpëtuar. Deviza jonë në këtë kontekst, kanë qenë dhe mbeten vargjet e famshëm të Xhelaludin Rumiut, i cili thotë: Eja! Eja! Kushdo që të jesh, prap eja! Mohues, zjarrdhurues ose idhujtar po të jesh eja! Selia jonë e Islamit, nuk është fole e pesimizmit! Njëqind herë po e ke prishur pendimin, prapë eja! Kur diversiteti vlerësohet si element dialogu, atëherë mozaiku fetar mbushet me dritë dhe përballë kësaj drite çdo shpirt shejtani verbohët. Vetëm në këtë sens, ne do të bëjmë të mundur të promovojmë liritë themelore të fesë dhe besimit. Unitetin e brendshëm të sendërtuar me aq mundim e sakrificë brenda

çdo feje apo besimi, filozofinë dhe doktrinat që na prijnë, ne vlen t'i konsiderojmë si frymë ekzistenciale për harmoninë e tyre, por askurrë si dukuri që na forcon për "t'u hedhur" në sulm ndaj komuniteteve të tjerë fetarë! Ne kemi qenë dhe mbetemi bij të një Zoti të vetëm. Më lejoni t'ju kujtoj thënien e vyer të Papa Gjon Pali II në vitin 1982 në Nigeri: "Ne adhurojmë Zotin dhe shpallim një nënshtrim të plotë ndaj Tij. Në këtë kuptim pra, mund të thërësim njeri-tjetrin vëllezër dhe motra për shkak të besimit në një Zot të vetëm." Solidariteti dhe vëllazëria jonë fetare besoj se do të mbeten jo thjeshtë një filozofi bashkuese, por një frymë e shenjtë, një udhëheqje për veprim, një realitet për të cilin vlen të kujdesemi për të gjithë. Kohërat që po kalojmë, ngjarjet e fundit në Zelandën e Re apo Holandë, na bëjnë më të vetëdijshëm në unitetin tonë për një paqe universale".

Gjatë këtyre ditëve të takimit të OSBE-ODIR në Vjenë, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, u takua dhe zhvilloi biseda të përzemërta me Kryetarin e Misionit të Përhershëm Sllovak në OSBE z. Branislav Lysak, me Kryetarin e këtij Misioni për Bosnje-Hercegovinën znj. Marjana Zybonja, me kreun e komunitetit mysliman në Itali, Jahja Sergio Jahe Pallavicini, me Rabinin Andrej Baker, me z. Emir Kovačević, President i Komisionit të lirive fetare të Bosnjë-Hercegovinës etj. Në këto biseda gati vëllazërore, u shtjelluan ideja dhe tematika të zhvillimeve të sotme fetare në botë, si dhe ide mbi rolin që duhet të luajnë liderët shtetërorë dhe ata shpirtërorë. Njëherazi, Kryegjyshi Botëror Bektashian, iu përgjigj bashkëbiseduesve rreth interesimit të tyre për tarikatin bektashi në përgjithësi, por edhe detyrave imediate që ka Selia e Shenjtë në Tiranë.

Koresp. "Urtësia"

Thirrje shpirti

Çeli gonxh' e trëndafililit

*Një ndryshim kish parë rrëmeti,
Që kur lindi Muhamedi,
An' e kënd rreth Arabisë,
Pritej agim' i lirisë!
Qabeja me mallëngjim,
Priste ditën për shpëtim,
Të pastrohej prej të këqijve,
Prej njëmijë perëndive, (idhujve)
Thirrje ndaj të madhit Zot,
Mbi këtë kube, në këtë rrotë,
T'a kumtonte madhështinë,
T'a shpëtonte gjithë njerëzinë,
Kët' detyrë kish' Muhamedi,
Me shokët që kishte pas vedi,
Që nga vdekja s'kishin frikë,
Erdhën dhe vdiqën besnikë,
Për Lailabe-il-lallahnë,
Çelën rrugën, kaluan vahnë,
Nga këta dhe me dituri,
Ka patur qenë Hajder Qerrari,
Që ka lindur në Qabe,
Shenjt' i shenjtëve me t'vërtetë,
Që Ebu Talibi ishte i jati,
Dhe Pejgamberi xhaxha e pati,
Fatimeja mëmë e Tij,
Thoshte: çështë o Perëndi,
Që ky foshnjë që në bark
Nuk më le të vij qark,
Për t'u falur në Qabe,
Mbas zakonit të mbaj fenë,
Në fenë e rrem'... s'e la Hajderi
Se kish lindur Pejgamberi,
Si yll sipër mbi Ehrame!
Sihariq! për fen' islame!
Në kopshtin e Hashimisë,*

*Që ishte si paradisë,
Pas tridhjetë vjet datës filit,
Çeli gonxh' e trëndafililit;
Rexhepi kishte trembëdhjetë,
Dit' xhumaje me t'vërtetë,
Dhjetë vjet para profetisë
Të Resultit Perëndisë
Njëzet e tre vjet para hixhretit,
Ka lindur Shahu i Velajetit.
Kush në bark të nënës vet
Ka njohur Zotin e vërtetë?
Kush ka lindur në Qabe?
Veçse Shahi Velajet!
Kush porsa ra në prehrë
Deshi me pa Pejgamberë?
Gojën s'e çeli për sisë,
Pejgamberi sa t'ja nisë,
Me gjuhën si myshkë-anber,
Nuri-nurin mori në prehrë,
Ai i tha: hajrul-velede,
I Fatimes bintel Esede,
Mir'se erdhe ja Ali!
Mir'se erdhe ja Veli!
Mir'se erdhe se të pret
Padyshim fe e vërtetë;
Ty të prisja unë përherë
Mir'se erdhe Hajderë!
Nga Zoti nasib s'ju bë,
Tjetër kujt në kët' dynja,
Ky nderim i Mustafasë,
Veç Alij-jel Myrtezasë.
Në doni shpirtin të kemi
Essalaty shokë të themi,
Për të madhin tonë Nebinë
Për të lartin tonë Alinë!*

O juve që keni besuar!

O juve që keni besuar!
 Bëhuni për Allahun qëndruës,
 Urdhrat e Tij duke i zbatuar,
 Bëhuni me të drejtë dëshmues,
 Le të mos u nxisë juve,
 Kurrën e kurrës mëria,
 Që i keni ndonjë kombi vetë,
 E t'u lëshojë nga padrejtësia,
 Bëni drejtësi t'u dëgjohet duaja,
 Se ajo është fare afër tek takvaja
 Dhe ndruheni Allahun me pushtet,
 Se Allahu me të vërtetë,
 E di çka punoni ju vetë.

Bëhuni njerëzit e mi!

S'i ka hije një njeriu kurrësesi,
 Që t'i japë Allahu:
 libër, mençuri dhe profeci,
 Pastaj t'u thotë njerëzve ai:
 «Bëhuni juve njerëzit e mi!
 Dhe lini Allahun plot fuqi!»
 Por duhet t'u thotë njerëzve:
 «Bëhuni ju të hyjëruar!
 Me çka ju ka mësuar libri vetë
 Dhe me çka juve keni mësuar!»

Tek tempulli i bekuar

Me të vërtetë Allahu plot fuqi,
 Vërtetoi ëndrrën e të Dërguarit të Tij,
 Që kështu me emrin e Hakkut, Ai,
 Do t'ju shpjerë me siguri
 Tek tempulli i shenjtë e i bekuar
 Më koka të qethura dhe me peçulle të shkurtuar.
 Mos keni frikë kësodore
 Se Ai di atë që nuk dini juve,
 Dhe Ai ka urdhëruar,
 Përveç kësaj një të afërme fitore!

Ai është Falësi

Ndërsa në gjuhën tonë:
 Thuaj nga ana ime o Muhamed!
 O shërbëtorët e mi!
 Juve që keni bërë mëkate tani,
 Kundër vehtes së vetë,
 Mos e prishni shpresën juve,
 Nga mëshira e Allahut të Vërtetë,
 Shiko! Allahu fal mëkatet së bashku të gjitha,
 Shiko! Ai është Falësi, Mëshiruesi pra.

Ai është i mjaftueshëm

Dhe i dhuroni atë vetë,
 Me gjëra që ai nuk kujtohet,
 Dhe ai që ka besim tek i Madhi Allah,
 Për atë Ai është i mjaftueshëm pra,
 Shiko! Allahu ia arrin qëllimit të tij të besuar,
 Për çdo send Allahu një qëllim ka caktuar.

Kjo është i mirësi

O juve që keni besuar
 Nëse ndonjëri nga ju në jetë
 Kthehet nga feja e vet,
 Zotin s'e ka dëmtuar,
 Se së shpejti sjell Allahu vetë,
 Një komb që Ai atë e do pra,
 Dhe që Atë e duan ata;
 I cili është i përulur vetë,
 Kundrejt besimtarëve,
 Por krenar i rreptë,
 Kundrejt mohuesve,
 N'udhë t'All-llahut luftojnë,
 S'frikësohen kurrë vetë,
 Nga fjalët e atyre,
 Që qëllimisht kritikojnë;
 Kjo është mirësi e All-llahut mbarë,
 Që ia fal atij që dëshiron vetë,
 Dhe All-llahu është i gjerë dijetar!

Shembull devocioni

Nga Nuri ÇUNI

Njëzetëdy vjet më parë u shua njëri prej klerikëve të vyer bektashianë, jeta e të cilit kaloi përmes vështirësive të panumërta dhe kalvarit të egër komunist. Jeta e tij, ka qenë dhe mbetet një shembull lavdie për ata që ecin të papërkulur në rrugën e hakut, sikundër dhe një frymëzim për brezat bektashianë në Shqipëri dhe më tej. Baba Bajram Mahmutaj, për gati 7 vite, ka qenë Zëvendës Kryegjysh Botëror. Ai ka qenë dhe mbetet një klerik i rrallë. Kam pasur fatin ta njoh nga afër në vitin 1994-1997, në Kryegjyshit, në biseda e takime, të cilat më kanë lënë mbresa të veçanta. Ruaj shumë kujtime nga kjo njohje e bashkëpunim, mes

tyre dhe një intervistë të gjatë me

'të, e cila do të ishte e fundit në këtë ejtë për klerikun.

Takimet me 'të më krijuan

staturën e një kleriku të

paepur në udhëtimin e tij

të hakut, udhëtim i gjatë

me punën përkushtuese

në dashurinë pakufi tek

Krijuesi dhe me bindjen e

plotë në dashuri të pashuar

ndaj Zotit. Ishte ky udhëtim

që e kaloi në gjithë jetën e tij.

Por portreti i baba Barjamit ishte

i veçantë dhe në moshën 88 vjeçare.

Rrudhat dhe thinjat e bënin sa fisnik, të matur, të urtë,

të ëmbël, me buzëqeshje dhe plot hijeshi, që vetëm

afrore dhe jepte mesazhin dhe gjithë atë kulturë e dije

të fituar në jetë dhe vështirësitë e kalvarit të tij dhe

familjes gjatë persekutimit 1945-1990. Në çdo bisedë

dhe takim ai kishte një moto, ta njohim bektashizmin,

rrënjët dhe historinë e tij, sintetizuar në fjalët e arta

të themeluesit të bektashizmit, Haxhi Bektash Veliut:

"Lutjes së Zotit mos iu nda./ Dijenin përvetsoje si armë në

dorë./ Mos ki turp të nxësh./ Mos kërko të metat e tjetrit,

shiko të metat e tua./ Trego drejtësi në çdo punë./Mos u

ngut kur përgjigjesh./Kurrë mos folë për veten tënde... etj".

Baba Bajrami na kujtonte shprehjen hyjnore të Haxhi

Bektash Veliut: "Mua nuk më nxë as qielli, as dheu im, më nxë vetëm zemra e besimtarët të bindur." Me një urtësi dhe dashamirësi të rrallë, gojëtar i ëmbël më tregoi mbi bektashizmin dhe jetën e tij. Biseda vinte nga vinte dhe strumbullari ishte "bektashizmi". Kjo doktrinë e pasur mistike, filozofike, kulturore, atdhetare, e mban besimtarin në linjën e jetës së njeriut për njeriun, edukimi i tij gjatë gjithë jetës me virtyte e larta; të urtësisë, të dashurisë, vëllazërisë e besimi te Zoti, te Kurani i famshëm, vinte në dukje ai. Por e veçanta është se bektashinjtë asnjëherë në besimin e tyre nuk e ndajnë atdheun, e kanë në zemër dhe duan, pavarësisht nga besimi, se Shqipëria ka historinë e saj. Bektashinjtë si dje dhe sot dhe në të ardhmen punojnë, me moton "Pa atdhe nuk ka fe".

Megjithëse në moshë të thyer, i

lodhur nga kalvari i jetës, vuaj-

tur në burgje dhe internime,

i sëmurë, por me zemër të

fortë, ai ishte ndër të parët

që me ardhjen e demokra-

cisë, në fillim të viteve '90,

erdhi nga Durrësi dhe

kontribuoi së bashku me

Dede Reshatin për ringritjen

dhe forcimin e Kryegjyshit

Botërore Bektashiane dhe u

zgjodh edhe si zëvendës i parë i

Kryegjyshit Botëror të Bektashinjtë deri

në prill të vitit 1997, kur ai ndërroi jetë.

Në bisedë e sipër ai më pyeti: "A ishe sivjet në Festën

e Abaz Aliut në Tomorr? -Po i thash, ndjeva kënaqësi në

këtë mal me histori të lashtë dhe simbol i bashkimit të

gjithë shqiptarëve. Më pas vijoi të fliste gjatë për festën

në Tomorr, ku nga gjithë Shqipëria shkojnë e falen në

malin e shenjtë që nga shekulli 16. Ky mal u quajt baba

Tomor, bashkoi shqiptarët në besë dhe fe. Më pas më

rrëfeu për teqenë e Prishtës, Backës, Kuçit, Therepelit.

Fliste me admirim për baba Fetahun, dervish Iljasin si një

dervish huan, ndërtonjës i udhëve, çezmave dhe puseve,

urave në gjithë jugun e Shqipërisë, dervish kalender

që la gjurmë dhe bëri histori. Më foli për baba Xhafer

Në

çdo bisedë dhe takim

ai kishte një moto, ta njohim

bektashizmin, rrënjët dhe historinë e tij,

sintetizuar në fjalët e arta të themeluesit të

bektashizmit, Haxhi Bektash Veliut: "Lutjes së Zotit

mos iu nda. Dijenin përvetsoje si armë në dorë. Mos

ki turp të nxësh. Mos kërko të metat e tjetrit, shiko

të metat e tua. Trego drejtësi në çdo punë. Mos

u ngut kur përgjigjesh.

Kurrë mos folë për veten


tënde".

Prishtën, baba Ali Turabiun, baba Meleq Shëmbërdhenjin. Më tregoi për teqetë e Beratit, ajo e baba Aliut afër urës së Goricës, e Velabishtit, Osmanëzezës, Vokopolës, Gllavës. Më tej shtoi: *“Me sa më kujtohet, baba Muharremi, më ka treguar, se kur misionarët e Sulltan Mahmutit të II-të, në vitin 1826, dogjën teqenë e baba Aliut në Berat së bashku me bibliotekën e pasur nga më të rrallat në Ballkan, me vepra të rralla në gjuhën persisht, arabisht, osmanish etj”*. Në disa Në biseda, shpesh shtonte: *“Besimi në Zot më mbajti gjallë!”*.

... Më 1925 në moshën nëntëmbëdhjetë vjeçare e vuri të shërbente në teqe, si kandidat për dervish. Dy vjet më vonë, në vitin 1927 u vesh dervish dhe punoi pa u lodhur në gjallërimin e teqesë dhe afrimin e sa më shumë besimtarë pranë saj. Dervish Barjami gjeti te baba Muharremi, prindin, edukatorin, mësuesin, teologun, atdhetarin shqiptar. Por nuk shkoi shumë dhe më 1929 ndërroi jetë babai i teqesë së Plashnikut. Megjithëse i ri, por me përvojën e fituar në këto vite pranë baba Muharremit, ky mori përsipër të drejtoj, si baba, teqenë. Këtu, ai afroi njerëzit, besimtarët, organizoi ceremonitë fetare, Sulltan Nevruzin, Matemin, Barjamin, të cilave u kushtonte rëndësi të veçantë. Ai shtoi pasurinë e teqesë, gjithashtu ndihmonte me pasion edhe teqetë e tjera në Berat, Osmanzesë, Velabisht, Vokopolë, Gllavë, Rabije, Tërpan etj. Në një dokument arkivor të datës 8 dhjetor 1939 firmosur nga Kryegjyshi Botëror Sali Nijazi Dede, në listën e teqeve bektashiane ky klerik është i regjistruar baba, në teqenë e Plashnikut të Beratit. Gjatë luftës teqeja e Velabishtit ishte konak për luftëtarët e lirisë. Me këtë përkushtim dhe vullnet punoi deri në vitin 1945. Por, mbas këtij viti nisi për të kalvari i vuajtjeve, persekutimi, burgosje, internime. Arrestohet dhe dënohet nga Gjykata Ushtarake e Beratit me akuzën absurde se kishte bashkëpunuar gjatë viteve të luftës me organizatën “tradhëtare” të Ballit Kombëtar. Dënimi ishte tejet i rëndë: 15 vjet burg! Ata që e patën njohur këtë klerik bektashi në burgjet e kohës, mbajnë mend mirë jo vetëm trimërinë e pashoqe të tij por edhe fjalën e ngrohtë, fjalë që shëronte shpirtrat pavarësisht se çfarë besimi kishin. Edhe kur mbaroi dënimin e burgut për pesëmbëdhjetë vjet, e internojnë në Milot, pranë Urës së Matit, ku qëndroi deri në vitin 1975. Baba Barjami nuk u ligështua, me durim përballoi vitet e internimit. Pas vitit 1975, ai qëndroi në familjen e nderuar të Teki Toros, në Durrës. U ribashkua me njerëzit e familjes, të afërmit prej të cilëve ishte ndarë që prej vitit 1945. Në vitin 1991 u bashkohet nismëtarëve për rihapjen e Kryegjyshit Botëror Bektashiane duke punuar me

gjithë shpirt, përsëri për bektashizmin. Gëzimi i madh ishte për të, 22 marsi e vitit 1991 me rastin e festës së Sulltan Nevruzit, që u rihap Kryegjyshata Botërore Bektashiane. Por e veçanta e kësaj ditë midis të tjerave ishte se në këtë festë mori pjesë shënjtoria e madhe nënë Tereza, e cila dha urimin e mrekullueshën *“Ta gëzoni rihapjen e Kryegjyshit Botëror Bektashiane!”*. Baba Barjami u takua me ‘të shkëbyen mendime, bashkë me klerikët Dede Reshat, baba Selim Kaliçani etj. Baba Barjami me intelektin dhe thellësinë e ideve, u bë krahu i djathë i Haxhi Dede Reshat Bardhit deri në çastet e fundit të jetës së tij. Ai mori pjesë në shumë ceremoni të rihapjes të teqeve në Shqipëri. Bëri vizitë në ish Qendrën Botërore në Turqi, Haxhi Bektash që ruhet si muze nga viti 1925. Ai rreth një vit qëndroi në teqenë e Detroitit në SHBA, më 1992. Baba Rexhebi iu lut të qëndronte në Amerikë. Por baba Barjami i tha: *“Unë jam i moshuar, dua Shqipërinë, të jetoj këto kohë në vendin tim me besimtarët, me njerëzit e mi të dashur!”*.

Baba Barjami është *“Pishtar i Demokracisë”* me motivacion: *“I pa përkulur dhe me besimin ndaj Zotit duroj burgjet e torturat e diktaturës për një Shqipëri të lirë, fetare dhe demokratike”*.



DERVISH SUFA TË QOFSHIM FALË

Nga Nuri Çuni

Në vështrimin historik të përhapjes së bektashizmit në vendin tonë, i cili filloi në Krujë nga misionari Sarisalltik, bashkohës i Haxhi Bektash Veliut në shekullin e XIII edhe sot kemi teqen në malin e Krujës dhe gjurmën në Krastë. Në shekujt pasardhës u hapën teqet e shumta në gjithë Shqipërinë, në fazat e zhvillimit të saj. Por do të shkruajmë këtë radhë për një figurë të bektashizmit, dervish Sufa, sa gjithë besimtarët krutanë e kanë quajtur edhe babë Sufa. Për origi-

nën e këtij kleriku sipas të dhënave burimore dhe gojore thuhet se fisi Kërçini janë nga Dibra e Madhe. Ardhur në Krujë në çerekun e parë të shekullit 18. Kjo lidhet me Hatemin një shënjtore i madh që ish shokë me Shememi Baban, të cilët janë diplomuar për teologji në Stamboll. Më pas u edukuan me mësimet e vjera të Haxhi Bektash Veliut në qendrën Botërore Bektashiane në Turqi dhe u veshën klerikë. Më vonë erdhën në Shqipëri. Shememi Baba shërbeu në teqenë e Fushë-Krujës dhe Hatemi në teqen e Gjormit. Ky fis, "Kërçini"

trashëgoi në breza besimin e kulluar bektashianë. Kërçini ishte fis i madh me klerikët e njohur Hajdar Kërçini (Hatemia) baba Sulejmani, dervishi i Sulejmanit. Mbas kalimit nga jeta klerikët e këtij fisi u varrosën në tyrben e madhe dhe tyrben e vogël të teqesë së Gjormit. Familja e njohur Kërçini e Krujës ka lidhje me fisin e Hatemisë të Gjormit në Mamuras. Kështu Avlla Kërçini pati dy djem Islamin dhe Mustafanë (i vitit 1836). Mustafai u martua me Gonxhen lindën dy djem Fazliun dhe Isufin (dervishin e ardhshëm)



në vitin 1873. Mustafai dhe Goxhnia ishin besimtarë dhe myhib, i cili mbas lindjes së Isufit u vesh dervish dhe shërbeu në teqenë e Shememi Babai në vitet 1879-1880, mbas kalimit nga jeta është varrosur pranë teqesë Shememi Baba. Trungu i kësaj familje është edhe me tri fise gjinore, Kërçini, Zhuku dhe Baltori. Prindërit e Isufit patën një kujdes të veçant për Isufin kurse djali tjetër i madhi, Fazlliu ishte përkrahës i luftës së Tallajbesë të vitit 1906, ai u vra nga turqit në Mamuras në vitin 1907. Ata patën edhe një vajzë, Hatixhen e martuar në Durrës te fisi Qehajt.

Jeta e Isufit ishte plot përkujdesje dhe dashuri prindërore dhe të kulturës bektashiane, që e mori nga prindërit, fisi dhe vizitat në teqen e Shememi Babait, Ball Efedi dhe ngjitja në malin e Krujës, Sarisalltik në ditët e pelegrinazhit. Në moshën 8 vjeçare 1881 filloi shkollën fillore turke me hoxhë mulla Hysen Topçin e Parë, që bënin mësim të xhamia e Varoshit, ku mësoi lëndët shkrim e këndim turqisht, arabisht, matematikë, edukatë fetare. Kuranin e mësonte me endje dhe ishte një nxënës i dalluar e mbaroi shkollën për 3 vjet, pra në vitin 1884. Djali 11 vjeçar dinte shumë sure kuranore përmendësh. Shpesh babai i tij, Mustafai e çonte te teqeja e Shememi Babait dhe merte pjesë familjarishtë në festat e ceremonit si Sulltan Nevruzi, Matemë dhe Ashurja, Barjami i Madh dhe i Vogël, duke u njohur gradulisht me shenjtorët e bektashizmit për Sarisalltikun, Shememi Baban, Hatemin, baba Hysen Kukelin, baba Haxhi Ismail Subashi. I jati, dervish Mustafai kaloi nga jeta në moshën 52 vjeçare, e la Isufin 15 vjeç. Por Isufi eci në rrugën e babait jo vetëm si besimtarë dhe njohu më shumë për historinë e bektashizmit.

Sepse ngrohtësia dhe dashuria për dervishin e ardhshëm e kish njohur babai i teqesë Shememi Babai, Haxhi Ismail Subashi, se tek ai pa jo vetëm edukatën familjare shkollën e bërë në Krujë, po cilësit e veçantë për tu bërë klerik i ardhshëm. Nuk e ndante asnjëherë nga vetja, në bisedat e ëmbla, nxitjen dhe përkushtimin për bektashizmin. Shpirti i ri, adhurimi erdhi duku u shtuar për të vazhduar rrugën e Hakut duke u bërë myhib dhe kaloi provat e përgatitjes si dervish të 1001 netëve, një kod bektashian, përgatitje rreth tre vjetë. Dervish Sufa njohu tek baba Haxhiu dashurinë e madhe ndaj Zotit, tek Krijuesi i Gjithësisë dhe gradën e lartë shpirtërore të tij. Vizitonte vendet e shenjta në Krujë dhe vende të tjera, mori një kulturë të përgjithshme bektashiane. Në vitin 1891, kur mbushi të tetëmbëdhjetat u bë dervish nga myrshidi, Haxhi Ismail Subashi. Mësoi shumë nga baba Haxhiu, jo vetëm kulturën fetare por e edukoi për atdhetarizëm. Këtë e tregojnë burimet historike se baba Haxhi Ismail Subashi për qëndrimin e tij antiosman së bashku me dervish Sufën për dy vite internohet në Nadan të Turqisë. Mbas internimit kthehen të dy në Krujë duke vazhduar drejtimin e teqesë dhe baba Haxhi Ismaili nuk e ndante asnjëherë dervishin në shërbimet fetare dhe administrimin e teqesë. Por shpirti i tyre atdhetar nuk u nda asnjëherë kur zhvillohej lufta në Shkodër me Malin e Zi, në vitin 1911. Me urdhër të baba Haxhiut luftëtarët vullnetarë të Krujës ushqeheshin nga teqeja e Shememi Babait dhe ushqimin e gatuar dervish Sufa.

Është interesantë se në kohën e rebelimit të Haxhi Qamilit, i cili dogji teqetë e "dervish Shabanit", "Zemzen Babait", "Ballë Efendisë"

dhe teqenë e Shehut në Kala. Në këtë situatë të vështirë baba Haxhiu së bashku me dervish Sufën iu kundërvun Haxhi Qamilit me një batalion vullnetarësh nga Kruja duke ndalur djegjet e tjera të teqeve në Krujë dhe kundër pushtimit serb. Mbas këtyre ngjarjeve baba Haxhiu në vitin 1917 transferohet në Hambaraj të Fierit, kur kaloi nga jeta baba Selim Qyshka i Parë, që drejtonte këtë teqe. Baba Haxhiu kaloi nga jeta në Hambaraj në vitin 1920. Dervish Sufa gjatë kësaj periudhe shërbeu edhe në teqetë e tjera të Krujës si "Haxhi Jahja Baba", në tyrben "Byjyk Abdall" dhe bënte shpesh herë vizita në zonën e Krujës dhe Dibërës në Martanesh, shkonte shpesh në Haxhi Bektash Turqi. Ai u bë shumë i njohur në Krujë por edhe në rrethinat e saj, se jo vetëm që dinte të drejtonte teqenë, por ishte edhe administrator i mirë, dallohej për cilësit e rralla, mistike dhe ka bërë shumë mrekulli sa edhe sotë i tregojnë besimtarët krutanë. Ky kalender u bë i famshëm se kishte një mendje të ndriçuar. Ai e njihnte shumë mirë Kuranin, dinte arabisht. Atë e respektonin të gjithë personalitete zyrtare, Abaz Kupi dhe vetë mbtreti Zog e njihje nga afër, shpesh e lejonin të vinte deri te zyra edhe me gomarin hipur. Është i njohur për mrekullitë e shumta që ka bërë sa mund të bëhet një libër i veçantë në këtë drejtim. Ai kaloi nga jeta në prill të vitit 1933. Në këtë kohë teqen e drejtonte baba Mehmeti, i cili e varrosi ku ndodhet sot tyrbja. Besimtarët e ndiznin kadilin çdo natë.

Dervish Sali Peti që shërben në teqen Kuzum Baba Vlorë, ka shërbyer për 12 vjet në teqetë e Krujës, më tregon me shumë respekt dhe adhurim për këtë dervish të famshëm se baba Ali Turabi Qazimllarit

i doli në ëndërr vet dervish Sufa me harka e me duar të lidhura. Babai e kishte pyetur: "Pse je i lidhur? Ai ishte përgjigjur: "Që unë të jem i lirë, duhet të kem tyrben time aty ku më kanë rënë kockat". Tyrbja iu ndërtua në vitin 1953. Por në vitin e mbrapsht 1967 nga regjimi komunist u prishën të gjitha objektet e kultit fetar. Por tyrbja e tij u rindërtua në vitin 1994 nga bamirësi i njohur Hysen Goci, më vonë është riparuar nga Ali Ramazan Veseli, i cili banon në Mamuras. Dervish Sali Peti vazhdon dhe tregon sa me mundim i gjetën eshtrat e tij. Sepse mbi varr ishte magazi plehrash kimike dhe hedhur beton çimento, por duke kërkuar u çua çimentoja dhe duke gërmuar dolën eshtrat për këtë këndohet kënga:

Dervish Sufa të qofshim falë

Me gjithë zemër, jo me fjalë,

Jezitia të munduan.

Merkatin tënd e sheshuan,

Shumë kërkova me të gjetë

Isharetin e dhe vetë, çave çimetos si harasan

E na the: "këtu jam".

Besimtarët e krujës në varrin e tij shkruan këtë epitaf:

Dervish Sufa të qofshim falë



Qeramete shumë tregove

Qoftë i vjetër apo djalë

Tërë krutanët i nderove.

Qerametet e dervish Sufës janë të shumta, se ai ishte mistikë dhe kish gradë të lartë shpirtërore ja disa: Nafije Maja: "Mua më vdiq djali 8 muajsh që e kish emrin Shkëlqim. Tri ditë mbas vdekjes së djalit më bëhet në ëndërr dervish Sufa, i cili më tha: "Nafije je e re, mos u hidhëro se Zoti së shpejti do të japi një djal tjetër, të cilit do t' i vini emrin Shkëlqim. Dhe ashtu ndodhi, mbas një viti lindi djali, të cilit i vura emrin Shkëlqim". Sabah Kau: "Disa të moshuar e pyetën një herë dervish Sufën: Pse qëndron shpesh te një ulli? Ai përgjigjet: "ulliri dhe fiku janë pemë të shenjta që Zoti i madh i përmend në Kuran". Ai thoshte: "Ky ulli, ku unë qëndroj, më tërheq, më shlodh, më heq mërzinë, ndaj shpesh ndez këtu qirin për shpirtat e erenlerëve" Sa populli sot i thonë: "(ulliri i babë Sufës". Çyr Kasëmi: Një ditë dervish Sufa ndodhej në Çudhi-Kamp kur, mori vesh se një vajzë 10 vjeçe ishte shumë sëmurë me temperaturë shumë të lartë, vjellje, thujse në koma. Shumë shpejt dervish vajti në shtëpinë e saj, pasi u përshëndosh ulet te oxhaku dhe u thotë të prindërve të saj: Mos u mërzitni. E zonja e shtëpisë ia solli vajzën dervishit para gjunjve. Dervishi urdhëroi prindërit të mernin tri grushta tagji nga strajsa e gomarit të dervishit dhe urdhëroi ti zienin me ujë. Me qetësi, dervish piu kafën me pak sheqer. Më pas, me lëngun e tagjisë së zijer dervishi, lugë pas luge e ushqeu vajzën dhe ajo u përmirësua menjëherë. Dervish Sufa është dekoruar nga Presidenti i Republikës në vitin 1995 me medaljen e veprimtarisë patriotike pas vdekjes. Me këtë motivacion: "Fetar dhe nationalist i shquar në luftë kundër pushtuesit për një Shqipëri të lirë e të bashkuar". Ky dervish kalender që u rrit dhe jetoi në Krujë u bë simbol i bektashizmit, fryma e tij, shpirti i paepur në rrugën e Hakut, punoi dhe drejtoi teqetë e Krujës. Por ai u njoh edhe si një kalender në udhëtime: Krujë, Martanesh, Tiranë, Durrës, Kavaj. Ai la gjurmë të jetës fetare, ndimues dhe bamirës i rrallë, ndihmonte të varfrit ishte ilaç për plagët, shëronte, i besës, përkrahës i fukaras, dhuratat dhe ndihmat që merte nga tregtarët dhe të pasurit ua shpërdante të vobekëve. Ai në jetën së tij, la mësimet e vyera të bektashizmit, Sot në këtë 86 përvjetor të përkujtimit të tij mbetet një kumt i paharruar i bektashizmit.

Lumturia më e lartë

Nga Nazim El-Kebris

Allahu na dhëntë nga urtësitë e Tij hyjnore, ngaqë ne mund të kemi dije, por nëse nuk kemi urtësi, dija nuk do të na hyjë në punë për asgjë. Ne kemi nevojë për urtësi, ndërsa pak urtësi është më e rëndësishme se dija e gjithë kësaj bote. Dija nuk mund t'ju tërheqë apo t'ju japë shtysë, por urtësia mund t'ju tërheqë apo t'ju japë shtysë. Në urtësi ka fuqi. Prandaj, dija pa urtësi nuk jep kurrë përfitim. Sikur dija të mund t'i jepte përfitim kujtdo, ajo do t'ia kishte dhënë Shejtanit. Ai është i pari për nga dija: ai i di Inxhabin Toran, Psalmet dhe Kur'anin e Shenjtë. Askush nga dijetarët nuk mund të konkurrojë me të; ai del i pari, ai di aq shumë. Por, pa urtësi; ai e kishte gjithë atë dije pa urtësi, ndaj edhe ra. Prandaj, nuk është me rëndësi të mësohet shumë, të dihet shumë, por është me rëndësi të kërkohen pak urtësi nga Allahu i Plotfuqishëm. Madje edhe një urtësi do t'ju mjaftonte përgjithmonë, për t'ju shpënë në lumturi dhe paqe këtu dhe në Botën e Përtejme, në kënaqësinë e Zotit tonë.

Allahu i Plotfuqishëm ka dërguar 6.666 ajete në Kur'anin e Shenjtë. Secili ajet është si një oqean i pafundmë, ndërsa oqeanet janë përplot me perla të çmuara. Mirëpo, sikur perlat të mund të zotëroheshin lehtë, ato do të ishin me çmim të lirë. Përse perlat janë të çmuara, të vlefshme? Ngaqë perlat mund të gjenden në vendet më të thella në detet, dhe vende të rrezikshme po ashtu. Allahu i Plotfuqishëm gjith-

monë e bën të mbrojtur diçka që është e vlefshme dhe e çmuar, që ajo të mos mund të jetë e arritshme aq lehtë. Një trëndafil pa gjemba dhe një thesar pa dragonj... jo!

Gjithçka që mund ta arrini lehtë është e lirë. Mund të blini domate, patate, qepë gjithandej, mirëpo rubinë, diamante, perla nuk mund të gjeni gjithandej, ndonëse mund të gjeni shumë të tilla prej qelqi. Prandaj, nga oqeanet mund të merrni peshq, mund të merrni guaska; deti vazhdimisht nxjerr guaca në breg, por kurrë nuk nxjerr perla. Ndërsa çdo ajet i Kur'anit të Shenjtë është si oqeane të pafundmë. Ai që mund ta bëjë veten të aftë për t'u zhytur, mund të marrë diçka.

Si mund të zhytet dikush në det me rroba? Askush nuk zhytet në detin e thellë i veshur me rroba; njerëzit duan të heqin nga vetja sa më shumë që munden për t'u zhytur. Ndërsa për "Oqeanet e Ajeteve", për Oqeanet e Kur'anit të Shenjtë, ju duhet të hiqni gjithçka nga vetja dhe pastaj të zhyteni në to. Çfarë do të zhvishni? Jo gjëra si këto rrobat. Ju duhet të hiqni nga zemra juaj gjithçka që i përket kësaj bote; ju duhet ta flakni tutje nga zemra juaj dynjanë, kënaqësitë e kësaj bote. E ju duhet ta dini se çfarë është dynjaja. Gjithçka që ju angazhon apo ju pushton nga Zoti juaj dhe ju ndjeni kënaqësi në të, është dynja; gjithçka që e zaptton një shërbëtor nga Zotëriu i tij — ajo është dynja. Kjo është pika më e rëndësishme për gjithsecilin, për çdo besimtar, pavarësisht nëse feja e tij është çifute, e krishterë apo muslimane: Kur Allahu i Plotfuqishëm shikon në zemrat e tyre, me kë janë të pushtuara zemrat e tyre?

Allahu i Plotfuqishëm nuk i shikon titujt, të cilët ne

ia vëmë vetes këtu — jo; Ai shikon në zemrat tona dhe sheh se me çka janë të pushtuara ato. A është zemra e angazhuar vetëm me Atë, apo me dynjanë? Ju duhet ta dini që Allahu i Plotfuqishëm i jep leje tërë trupit tuaj që të punojë, të angazhohet nga kjo jetë, përveçse zemrës suaj. Ju mund të jeni të zënë përmes trupit tuaj, nuk ka rëndësi, ngaqë ne jetojmë në këtë jetë dhe kemi disa përgjegjësi. Allahu i Plotfuqishëm u lejon organeve tona të shkojnë, të vijnë, të shohin, të bëjnë, mirëpo Ai thotë: “Vetëm zemrën tuaj - mos e lini atë të angazhohet nga dynjaja”.

Ruajeni zemrën tuaj vetëm për Zotin tuaj dhe Ai do të jetë i kënaqur me ju. E kur Ai të jetë i kënaqur me ju, Ai do t’ju bëjë edhe juve të kënaqur me Të. Kjo është sa’adet’ul- kubra, lumturia më e lartë. Ju do t’ju ishte dhënë lumturi e pafundme kur Allahu i Plotfuqishëm ju bën të kënaqur. Ne kërkojmë kënaqësinë e Tij me ne, ne përpiqemi ta bëjmë Atë të kënaqur me ne. Asgjë, përveç kësaj, nuk i jep kënaqësi Zotit tonë me ne. Kënaqësia e plotë nga Allahu i Plotfuqishëm me shërbëtorët e Tij është kur shërbëtorët e Tij ia japin zemrat e tyre Atij të Plotfuqishmit. Mirëpo, kjo nuk është e lehtë, është ky urdhri më i vështirë dhe më i rëndësishmi nga adhurimet. Ndërsa çdo adhurim dhe lutje që ne kryejmë me trupat tanë, adhurimi trupor, është vetëm për atë qëllim: për të bartur nga trupat tanë në zemrat tona, ngaqë adhurimi i jep respektet tona Zotit tonë. Ne respektet tona i japim me organet tona dhe kjo është brenda kufijve; mirëpo, për atë që jep respektin e tij me zemrën e tij, kjo do të jetë e pakufishme. E ne jemi urdhëruar që ta adhurojmë Zotin tonë pa kufij. Ju nuk mund ta bëni atë me trupat tuaj, por mund ta bëni me zemrat tuaja. Është kjo një urtësi që duhet ditur dhe mbi të cilën duhet punuar. Dhe kjo na” mjafton, më tepër se të studiojmë me mijëra e mijëra libra për të bërë stoqe diturie. Pastaj nuk do të mund ta mbanit gjithë atë; është një barrë shumë e rëndë. Mirëpo është urtësi e përmbledhur që na bën të lëvizim drejt Zotit

tonë. Ai na fton, e ne duhet të shkojmë tek Ai. Allahu i Plotfuqishëm zgjedh nga shërbëtorët e Tij për t’i dhënë urtësitë e Tij hyjnore. Kur Ai shikon në zemrën e shërbëtorit të Tij dhe e sheh Vetën, Ai atëherë i jep atij personi nga urtësitë e Veta hyjnore. Mirëpo, nëse kushdo qoftë e man zemrën e tij për dynjanë, për nefsin e tij, atij mund t’i jepet shumë dituri, por pa përfitim. Prandaj Profeti kërkonte nga Zoti i tij i Plotfuqishëm “ilmen naf’ien” dituri që jep përfitim — e kjo është hikmet, kjo është urtësia. Nuk do të jetë e lehtë. Ne duhet të punojmë në këtë drejtim. Dhe fillimisht, ju duhet t’ia prisni dëshirat egos suaj dhe duhet t’i vendosni një kufi egos tuaj, dëshirave të tij. Nëse e lini egon tuaj, nefsin tuaj, të lirë, nuk do të mund të gjeni kufi për dëshirat e tij; prandaj ai vazhdimisht ju pushton juve dhe ju bën skllav të tij; nuk keni kohë për t’i shërbyer Zotit tuaj, për adhurimin e Zotit tuaj. Prandaj, ne duhet t’i vendosim kufi nefsit tonë, dëshirave të tij. Ndërsa ne jetojmë në një kohë dhe në një vend ku gjithçka i shtyn egot tona të ‘kërkojnë gjithnjë e më shumë — dëshira të pakufishme.

Së pari, ne duhet ta ndërpresim këtë. Ju duhet të thoni: “Ky është kufiri yt” - për të ngrënë, për të pirë, për veshjen, për punën, ngaqë të gjithë librat e shenjtë kanë ardhur me urdhra hyjnorë për t’u vendosur kufij Bijve të Ademit, dhe kjo është e njohur mirë si hallalli dhe harami, e lejuara dhe e ndaluara. Allahu i Plotfuqishëm vendos kufij: mos kaloni mbi ta. Ata janë kufijtë, dhe nëse ju nuk e vendosni atë pengesë, ju duhet gjithsesi t’i kapërceni ata. Ndërsa i gjithë Sheriati është për të gjithë njerëzit, për çdo Bir të Ademit; çdokush ka përgjegjësi për ta ruajtur atë Sheriat.

Allahu i Plotfuqishëm i njuh egot tona dhe dëshirat e tyre; Ai i njuh ato në mënyrë të përsosur. Nëse nuk u vendosim kufi, kjo do të ishte e rrezikshme dhe e tmerrshme. Hapi i parë është të dihen ata kufij. Mos e lejoni egon tuaj të kërkojë gjithçka nga ju pa kufij. Tani



gjendemi në muajin e shenjtë të agjërimit. Ky agjërimit na mëson se si duhet të jemi në gjendje t'i vëmë kufi dëshirave të egos sonë; prandaj edhe është adhurimi më i rëndësishëm. Pa atë adhurim, është e pamundur të qëndrohet përballë egos suaj dhe t'i drejtohet atij, të rregullohet ai: "Bëje këtë, lëre atë". Nëse nuk mund ta bëni këtë, ju jeni të dobët dhe egoja juaj kalëron mbi ju dhe ju udhëheq ngado që dëshiron ajo, dhe kjo është e rrezikshme dhe e tmerrshme. Prandaj, agjërimit është dera kryesore për çdo adhurim, ngase është e padobishme të adhurohet teksa nuk jeni në gjendje të qëndroni përballë egos tuaj dhe ta urdhëroni atë. Dhe kur lëvizim drejt Allahut të Plotfuqishëm, kur shërbëtorët e kërkojnë Zotëriun e tyre dhe shkojnë drejt Pranisë Hyjnore të Tij, edhe Ai bën që vullneti i Tij t'iu afrohet shërbëtorëve të Tij. Kur ju bëni një hap, Ai i urdhëron qëllimet tuaja të vijë dhjetë hapa më pranë. Nganjëherë qëllimi ynë vjen aq afër, saqë ne mund ta arrijmë nëse mund të hedhim edhe një hap; por egoja jonë, nefsi ynë, e ndërpret rrugën. Kur ndodh kjo, ne e gjemë veten shumë larg. Ne nuk kujdesemi për gjërat e vogla, por ato na shkaktojnë aq shumë dëm, dhe bëjnë që të jemi aty ku kemi qenë në hapin e parë, duke dështuar. Prandaj, çdo besimtar, çdo mysliman, duhet ta dijë se kur ai lëviz drejt Zotit të tij, ka katër armiq përreth tij, që e bëjnë të kthehet nga rruga e tij. Nëse dëshironi të bëni një hap, njëqind satanë vijnë për ta penguar hapërimin tuaj; pastaj një mijë ju sulmojnë që t'ju sprapsin. Ju nuk mund ta bëni atë pa fuqinë e Zotit tuaj. Prandaj, ne themi: 'La havle ve la kuvvete

il-la bil-Lah el-Alij el-Adhim", pra themi: "O Zoti ynë, ne nuk mund të kthejmë nga rruga e keqe në rrugën Tënde të mirë pa fuqinë Tënde, pa vullnetin Tënd. O Zoti ynë, na jep nga fuqia Jote hyjnore, për t'i bërë këmbët tona të vendosura në rrugën Tënde". Këto ditë dhe net të Ramazanit vijnë një herë çdo vit dhe ato do të mbarojnë shpejt. Ato janë ditë ganimesh, ditë thesaresh, gjërash të çmuara dhe po ashtu ditët më të hapura për Oqeanet e Mëshirës hyjnore. Ndërsa Zoti ynë pret nga ne të kërkojmë sa më shumë nga mëshirat dhe fuqitë e Tij hyjnore, dhe mbështetjet gjithnjë e më të madhe për vetveten.

Ju duhet të kërkonit, sidomos gjatë së tretës së fundit të Ramazanit të Shenjtë, kur një nga netët do të jetë Nata e Fuqisë, Lejlet'ul-Kadr - veçanërisht ta kërkonit atë natë. Ta gjeni manifestimin në atë Natë të shenjtë - ky është qëllimi ynë gjatë jetëve tona, ndërsa atij që i është mundësuar ta gjejë atë Natë, Allahu i Plotfuqishëm e merr atë në mbrojtjen e Tij hyjnore. Atij që e gjen Natën e Fuqisë i dhurohen nga Zoti i tij Oqeanet Mëshire të pafundme dhe favore të pafundme, dhe ai është i mbrojtur. Nëse profetët janë të pafaj, ai që e ka gjetur Natën e Fuqisë ka atributin e të qenët i mbrojtur; ndërsa ai që është i mbrojtur me favore hyjnore, është e pamundur për Satanin që t'i avitet dhe ta nxjerrë atë nga mbrojtja e Zotit tonë. Ne duhet të përpiqemi. Ne jemi njerëz aq të dobët në besimin tonë për ta gjetur atë Natë, por ne e lusim Zotin tonë të na japë nga bereqeti i asaj Nate, nga bekimet e saj, ndërsa ai bereqet mund të na japë po ashtu mbrojtje përgjithmonë.



HUMANISM AS THE FOUNDATION OF PEACE

From the speech of the Bektashi World Leader, His Grace Hajj Dede Edmond Brahimaj



Bismilahi, Rahmani, Rahim!

In the name of God, the Most Beneficent, the Most Merciful.

Dear organizers of this conference!

My brothers, representatives of religions in Albania! It is a special pleasure to take part in this event and let me congratulate you on the qualities of the Bektashi World Leader and in the name of millions of believers around the world: Happiness and prosperity in your families!

The Supreme Lord reward the devotion you confess to it!

Principles of religious tolerance have been plagued since the birth of Islam,

through those centuries of wonders where ignorance lay in human spirits. A religion or belief can not arise and develop without having in its embryo of religious coexistence, in the communication with the heart to anyone, regardless of race, color or ethnicity. Here is not the place to make history, but now Muslim historiography and not only, has long evidenced the miraculous conduct of Prophet Muhammad (peace be upon him) to his enemies on the day he entered liberation in Mecca. He defeated within himself every vengeful feeling inviting his followers to outline the great forms of universal Islamic

mercy. But even in the following years, even after fierce physical attacks and doctrinal thoughts, the idea of religious tolerance fed the followers of Islam in all the places where they represented this religion where they were inclined to be educated with this divine spirit. Even if you consider religious contexts in the first centuries of Islam's birth, I think of reminding you today of our Prophet's wonderful expression, which warns the adversaries that: "We will make them able to see the arguments to the horizons and within themselves, to the extent that it becomes apparent that it (the Qur'an) is true. Is it

not enough that your Lord is a witness to everything?" (Qur'an, Fussilet: 53).

Although our fate, Albanians, has gone through the Balkan unrest and beyond, we can at least be proud of the spirit of tolerance among religions. This act, of course, is God's will, but it is worth not to be forgotten for a moment that clergy and cult objects, mosques, churches, tekkes or others, with that proverbial compassion for the Fatherland, have been able to educate generations of believers with devotion steadfast to the Creator.

It is this devotion that has filled our hearts with love for the brothers we have in our side, and in many cases we have found great inspiration within the religious family, adding relevant values to the biological family itself.

The Bektashi tarikat belongs, from eight centuries of birth and its development, from Asia to Europe and to the United States of America and Canada

it is like a vast and majestic river, which in the depths of its waters, carries the pearls of love to the Creator, Homeland, the family, and the most precious human morality. Feeding with the reverence for the essence of the goodness found in every person, we have always perceived sin as his enemy, while the sinner as a winged bird in the storm, seeking not merely mercy but also help to save. Our currency in this context has been and remains the famous verses of Jalaludin Rumi, who says:

Come on! Come on! Whoever you are, come again!

Denying, firing or idolatrous if you are coming!

Our headquarters in Islam, is not the nest of pessimism!

One hundred times you have broken the repentance, come again!

When diversity is considered as the element of dialogue, then the religious mosaic is filled with light and in the face of that light every Shaytan spirit is

blinded. Only in this sense we will be able to promote the fundamental freedoms of religion and belief. The internal unity created with such torment and sacrifice within each religion or belief, philosophy and doctrines that we are leading to, is worth considering as an existential spirit for their harmony but as a phenomenon that strengthens us to " "In attacking other religious communities!

We have been and remain children of one God. Let me remind you of Pope John Paul II's precious statement in 1982 in

Nigeria: "We worship God and declare a complete submission to Him. In this sense, we can call each other brothers and sisters because of the belief in one God. "Our solidarity and religious brotherhood I believe will remain not merely a union philosophy, but a holy spirit, a leadership for action, a reality that we all care about. The times we are going through, the recent events in New Zealand or the Netherlands, make us more aware of our unity for universal peace.

The Bektashi tarikat belongs, from eight centuries of birth and its development, from Asia to Europe and to the United States of America and Canada it is like a vast and majestic river, which in the depths of its waters, carries the pearls of love to the Creator, Homeland, the family, and the most precious human morality. Feeding with the reverence for the essence of the goodness found in every person, we have always perceived sin as his enemy, while the sinner as a winged bird in the storm, seeking not merely mercy but also help to save. Our currency in this context has been and remains the famous verses of Jalaludin Rumi, who says:

Come on! Come on! Whoever you are, come again!
Denying, firing or idolatrous if you are coming!
Our headquarters in Islam, is not the nest of pessimism!
One hundred times you have broken the repentance, come again!



URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE

NR.131 PRILL 2019

